

**UNIVERSITETI I MALIT TË ZI - FAKULTETI FILOZOFIK**



**Leon Dedvukaj**

**KOMUNIKIMI MËSUES-PRIND DHE NDIKIMI I TIJ NË  
ARRITJET E NXËNËSVE**

**PUNIM MASTER**

**Podgoricë, 2022**

## **INFORMACIONI I STUDENTIT**

**Emri dhe mbiemri-** Leon Dedvukaj

**Data dhe vendi i lindjes-** 25 shtatorë 1999, Podgoricë

**Emri i programit të studimit universitar të përfunduar dhe viti i përfundimit të studimeve-** Programi studimor për arsimin e mësuesve në gjuhën shqipe, përfunduar në vitin 2022

## **INFORMACIONI I PUNIMIT MASTER**

**Emri i studimeve master-** Studime master 5 vjeçare, me sistem të ri

**Titulli i punimit-** Komunikimi mësues-prind dhe ndikimi i tij në arritjet e nxënësve

**Fakulteti/akademia ku u mbrojt vepra-**

## **VLERËSIMI DHE MBROJTJA E TEZËS SË MASTERIT**

**Data e aplikimit për temën e masterit-** 25 janarë 2022

**Data e mbledhjes së këshillit në të cilën u pranua tema-**

**Emri i udhëheqësit shkencor dhe i anëtarëve të komisionit-** Udhëheqësi shkencor është Dr. Visar Dizdari dhe anëtarët e komisionit janë: Prof. Gezim Dibra dhe Prof. Fatmir Vadohej

**Data e mbrojtjes-**

**Data e promovimit-**

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Duke mbajtur përgjegjësinë time për këtë studim, unë deklaroj se këtë punim e kam shkruar unë dhe kërkimin në shkolla e kam bërë unë. Ky studim nuk është botuar dhe prezantuar më parë. Gjithçka që do të prezantohet nga ky punim është puna ime që e kam përgatitur unë, përpos disa rasteve që i kam cituar tek literatura.

Leon Dedvokaj  
EMRI DHE MBIEMRI

Leon. D  
NËNSHKRIMI

## **ABSTRAKTI**

Ky punim trajton rëndësinë e bashkëpunimit mësues-prind dhe përfitimet që kanë shkollat dhe familjet nga ky bashkëpunim. Qëllimi i këtij studimi është të hetohet nëse komunikimi i vazhdueshëm mësues-prind dhe arsimit të dy prindërve ndikojnë pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve. Informacioni për arritjet e nxënësve dhe për pjesëmarrjen e prindërve të tyre në shkollë është mbledhur me anë të pyetësorëve, plotësuar nga mësuesit. Po ashtu, janë marrë nëpërmjet pyetësorëve të tjerë edhe vlerësimet e mësuesve dhe prindërve lidhur me format e ndryshme të komunikimit me njëri-tjetrin.

Rezultatet kryesore tregojnë se format më të dëshirueshme të komunikimit mes mësuesve dhe prindërve janë: biseda telefonike dhe mbledhjet në shkollë, kurse forma e komunikimit aspak e pëlqyeshme është vizita në shtëpi. Rezultatet kryesore tregojnë se ka korrelacion pozitiv të dobët mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje. Kjo vjen për arsye se shumica e nxënësve të shkollës fillore, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, kanë sukses të lartë dhe po ashtu, ka në përgjithësi përkujdesje të lartë të prindërve në hapat e parë të shkollimit të fëmijëve të tyre, reflektuar me komunikim të vazhdueshëm mësues-prind. Gjithashtu, rezultatet kryesore tregojnë se ka korrelacion pozitiv mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe arsimit të dy prindërve, pra nxënësit të cilët i kanë prindërit me arsim të lartë, kanë sukses më të lartë në shkollë, krahasuar me nxënësit të cilët i kanë prindërit me arsim të mesëm apo fillor.

## **ABSTRACT**

This paper addresses the importance of teacher-parent collaboration and the benefits that schools and families have from this collaboration. The purpose of this study is to investigate whether continuous teacher-parent communication and education of both parents positively affect students school achievement. Information about the achievements of the students and about the participation of their parents in school was collected through questionnaires completed by the teachers. Also, through other questionnaires teachers and parents evaluations regarding the different forms of communication with each other were obtained.

The main results show that the most desirable forms of communication between teachers and parents are: telephone conversations and meetings at school, while the least desirable form of communication is home visits. The main results show that there is a weak positive correlation between the success rate of the students and the attendance of the parents at the meeting. This is because most of the elementary school students, from the first grade to the fifth grade, have high success and also, there is generally high care of parents in the first steps of their children's education, reflected by continuous teacher-parent communication. Also, the main results show that there is a positive correlation between the success rate of students and the education of both parents, that is, students who have parents with higher education, have higher success in school, compared to students whose parents with secondary or primary education.

## STRUKTURA E PUNIMIT

<b>FALËNDERIME</b> .....	7
<b>PËRCAKTIMI I TERMAVE</b> .....	8
<b>HYRJE</b> .....	9
<b>1.SHQYRTIMI I LITERATURËS</b>	
1.1. Përfshirja e prindërve në shkollë.....	11
1.2. Ndryshimi dhe zhvillimi i marrëdhënies mësues-prind.....	13
1.3. Faktorët që pengojnë përfshirjen e prindërve në shkollë.....	16
1.4. Faktorët që mundësojnë përfshirjen e prindërve në shkollë.....	19
1.5. Komunikimi mësues-prind dhe format e komunikimit.....	21
1.6. Arsytet e moskomunikimit dhe pengesat në marrëdhënien mësues-prind.....	24
<b>2.METODOLOGJIA E PUNIMIT</b>	
2.1. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit.....	26
2.2. Popullsia, kampionimi dhe përzgjedhja e rasteve.....	27
2.3. Metodatat, teknikat dhe instrumentet e kërkimit shkencor.....	29
2.4. Mbledhja e të dhënave.....	32
2.5. Analiza e të dhënave.....	33
<b>3.PARAQITJA E REZULTATEVE</b>	
3.1. Të dhënat e nxënësve.....	34
3.2. Opinione të mësuesve për rëndësinë e komunikimit me prindërit.....	40
3.3. Opinione të prindërve për rëndësinë e komunikimit me mësuesit.....	50
3.4. Krahasimi i opinionit të mësuesve dhe prindërve në lidhje me komunikimin.....	62
3.5. Prindi që merr pjesë më së shumti në mbledhjet në shkollë.....	64
3.6. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje.....	65
3.7. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe shumës së arsimit të dy prindërve.....	66
<b>4.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b>	
4.1. Përfundime.....	67
4.2. Kufizimet e kërkimit.....	68
4.3. Rekomandime.....	69
<b>BIBLIOGRAFIA</b> .....	70
<b>ANEKS</b> .....	72

## **FALËNDERIME**

Falënderoj udhëheqësin shkencor Dr. Visar Dizdarin, për të gjitha udhëzimet që më ka dhënë lidhur me punimin tim.

Falënderoj Prof. Fatbardha Osmanaga, e cila më ka ndihmuar të gjejë disa materiale për literaturën.

Falënderoj mësuesit dhe prindërit, të cilët kanë pranuar të jenë pjesë e studimit tim, duke më dhënë informacion për nxënësit, të cilët ishin objekti i analizës.

## PËRCAKTIMI I TERMAVE

Këtu do të paraqes disa fjalë që i kam përdorur në këtë punim, të cilat mundën të jenë të panjohura, të shoqëruera me nga një apo dy shembuj.

**B**ashkëveprim- kur individët veprojnë me njëri-tjetrin së bashku njëkohësisht, shembull: bashkëveprimi i mësuesve me prindërit.

**D**obi- e mira që vjen nga një punë, nga një veprim, shembull: dobia e punimit, marrëdhënia mësues-prind sjellë dobi.

**E**tj- shkurtimi i fjalës “e të tjera”, shembull: të dhënat e nxënësve janë: gjinia, sukcesi, etj.

**E**kspertizë- hetimi a shqyrtimi nga eksperti, raporti që jepet pas këtij hetimi a shqyrtimi, shembull: studiuesit i kanë shpërndarë pyetësorët për ekspertizë, disa mësuesve dhe prindërve.

**H**armonizim- që është vënë në përputhje a në pajtim me diçka tjetër, shembull: bashkëpunimi me komunitetin vendor ka të bëjë me harmonizimin e nevojave të ndërsjella të familjes, shkollës dhe komunitetit lokal.

**K**onstruktive- që sjellë të mira, duke treguar jo vetëm të metat e një pune, por edhe se si bëhet ajo më mirë, shembull: marrëdhënia konstruktive mësues-prind.

**K**onsultim- kur individët i drejtohen dikujt për të marrë mendimin e tij për një punë apo për një çështje, shembull: mësuesi konsultohet me prindërit, për çështje të ndryshme.

**M**irëqenie- gjendje e mirë nga ana shëndetësore, shembull: marrëdhënia e fëmijëve me prindërit, e forcon mirëqenien e tyre.

**N**dërsjellë- që bëhet në të mirë të dy palëve, i dyanshëm, reciprok, shembull: përfitimi i ndërsjellë i mësuesve dhe prindërve.

**P**rsh- shkurtimi i fjalës “për shembull”, shembull: nxënësit nga klasa e parë, deri në klasën e pestë kanë një mësues që u mban shumicën e orëve mësimore, prsh: gjuhën shqipe, matematikën, etj.



## HYRJE

Komunikimi është aspekt shumë i rëndësishëm i partneritetit të suksesshëm në mes shkollës dhe familjes. Siç dihet, edukimi fillestar fillon në familje dhe prindërit janë mësuesit e parë të fëmijës së tyre. Është vërtetuar nga shumë studime të bëra në vende të ndryshme të botës, se sa më e madhe të jetë përfshirja e prindërve në shkollë, aq më i përparuar është fëmija në çdo aspekt. Në marrëdhënien mësues-prind, përfshihen disa faktor, siç janë: edukimi, familja dhe mësuesit, të cilët kanë qëllim formimin e plotë të personalitetit të fëmijës. Arsyeja kryesore pse e kam zgjedhur këtë temë është sepse ka të bëjë me fushën e edukimit, ashtu siç e kam zgjedhur edhe unë drejtimin dhe kjo më ka nxitur që të bëj kërkimin në këtë fushë.

Me këtë kërkim, dua të hetoj se sa ndikon përfshirja e prindërve dhe arsimit i të dy prindërve në arritjet e nxënësve në shkollë dhe në sjelljen e tyre. Pra, dua të shikoj nëse të gjithë nxënësit që i kanë prindërit e përfshirë në shkollë dhe i kanë prindërit me arsim të lartë, a kanë rezultate të larta në shkollë apo ka nxënës të cilët janë të talentuar dhe nuk ndikohen nga përfshirja e prindërve apo arsimit i prindërve.

Në kërkim do të paraqitet edhe interesimi i prindërve për të bashkëpunuar me shkollën.

Do të shikojmë nëse prindërit bëjnë vizita në shkollë vetëm kur i fton mësuesi, kur organizon mbledhjet me prindër apo prindërit e vizitojnë vazhdimisht mësuesin në shkollë dhe janë të interesuar që të marrin më shumë informacion për fëmijën e tyre, lidhur me arritjet akademike apo për sjelljen e tij.

Qëllimi i kërkimit është hetimi mbi ndikimin që ka bashkëpunimi mësues-prind në arritjet shkollë të nxënësve. Studimi që do të bëj, ka si synim të paraqes rezultatet mbi përfshirjen e prindërve në shkollë dhe ndikimin që ka kjo përfshirje në arritjet e nxënësve në shkollë.

Gjithashtu studimi do të paraqes edhe rezultatet lidhur me ndikimin e bashkëpunimit mësues-prind në përmirësimin e sjelljeve të nxënësve, si në shkollë apo edhe jashtë saj, siç janë: pengimi i mësuesit gjatë shpjegimit, pjesëmarrja në orët mësimore, respektimi i shokëve dhe shoqëve, etj. Pra, dua të hetoj nëse sjellja e nxënësve në shkollë përmirësohet nëse prindërit e tyre janë të përfshirë në shkollë dhe kanë marrëdhënie të mirë me mësuesin.

Dobia e punimit është përmirësimi i cilësisë së edukimit të fëmijëve, duke ngritur nivelin e përfshirjes së prindërve në shkollë dhe në çështjet e arsimit në përgjithësi.

Si përfundim, mund të them se një nga arsyet se pse dua të bëj këtë kërkim është sepse dua të kontribuoj me anë të këtij studimi, që t'u paraqes shoqërisë rezultatet se sa janë të përfshirë prindërit në shkollat fillore të Komunës së Tuzit. Ky është kërkimi i parë shkencor që bëhet për këtë fenomen në shkollat e Komunës së Tuzit, pra për marrëdhënien mësues-prind dhe ndikimin e saj në arritjet e nxënësve, dhe dua të nxjerrë rezultate sa më të sakta.

Si objektivi i parë, është “të hetoj ndikimin që ka komunikimi mes mësuesve dhe prindërve në arritjet shkollë të nxënësve”. Si objektivi i dytë, është “të shqyrtoj nëse ka ndikim arsimimi i prindërve në arritjet shkollë të nxënësve”. Përpos të dhënave të nxënësve, kam dashur të marrë informacion edhe për opinionet e mësuesve dhe të prindërve lidhur me komunikimin e tyre me njëri-tjetrin. Kështu, si objektivi i tretë, është “të hetoj se cilat janë arsyet më të shpeshta që mësuesit dhe prindërit komunikojnë së bashku”. Objektivi i katërt, është “të hetoj se sa shpesh komunikojnë mësuesit dhe prindërit me njëri-tjetrin”. Objektivi i pestë, është “të hetoj se cilat probleme hasin mësuesit dhe prindërit gjatë komunikimit me njëri-tjetrin”. Objektivi i gjashtë, është “të shqyrtoj se si e vlerësojnë mësuesit dhe prindërit komunikimin me njëri-tjetrin, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollë dhe sjelljes së nxënësve”.

Dhe objektiva e shtatë është “të hetoj se cilat janë format e komunikimit më të dëshirueshme të mësuesve dhe prindërve që të komunikojnë me njëri-tjetrin”. Pra, objektivat kryesore të punimit janë për të marrë informacion për disa pyetje kërkimore, të cilat janë të paraqitura më poshtë.

Pyetjet kërkimore janë:

Çfarë ndikimi ka komunikimi mësues-prind në arritjet shkollore të nxënësve?

A ndikon arsimi i të dy prindërve që nxënësit të kenë arritje të larta akademike në shkollë?

Cilat janë arsyet më të shpeshta që mësuesit dhe prindërit komunikojnë së bashku?

Sa shpesh komunikojnë mësuesit dhe prindërit me njëri-tjetrin?

Cilat probleme hasin mësuesit dhe prindërit gjatë komunikimit me njëri-tjetrin?

Si e vlerësojnë mësuesit dhe prindërit komunikimin me njëri-tjetrin, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljes së nxënësve?

Cilat janë format e komunikimit më të dëshirueshme të mësuesve dhe prindërve që të komunikojnë me njëri-tjetrin?

Kurse hipotezat janë:

Komunikimi i vazhdueshëm mësues-prind ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve,

Arsimi i prindërve ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve.

## **1.SHQYRTIMI I LITERATURËS**

### **1.1. Përfshirja e prindërve në shkollë**

Përfshirja e prindërve në shkollë konsiderohet si themelore për arritjet e larta të nxënësve dhe për përmirësimin e sjelljes së nxënësve në shkolla.

Me përfshirjen e prindërve në procesin mësimor (shkollë), kuptohet që prindërit së bashku me mësuesit ndajnë përgjegjësinë për të mësuar nxënësit dhe për të punuar së bashku, për t'i arritur qëllimet e tyre mësimore dhe për zhvillimin e fëmijës, që është qëllimi kryesorë.

Përfshirja e prindërve në shkollë është një koncept që lidhet me aktivitete të ndryshme, duke përfshirë punën e prindërit që ka në shtëpi, siç është: ndihma që i jep fëmijës lidhur me detyrat, etj, dhe punën e prindërit që lidhet me shkollën, siç është: komunikimi me mësuesin në lidhje me arritjet apo sjelljen e fëmijës, etj. Në shumicën e rasteve, prindërit mendojnë se arsimimi i fëmijës së tyre është vetëm në duart e mësuesit, por hulumtimet tregojnë se nxënësit që i kanë prindërit e përfshirë në shkollë kanë më shumë mundësi të kenë rezultate të larta në shkolla, të ndjekin në mënyrë të rregullt procesin mësimor apo të kenë sjellje më të mirë, krahasuar me nxënësit të cilët nuk i kanë prindërit e përfshirë në shkollë, pra kur shkollat dhe familjet bashkëpunojnë bashkë, fëmijët kanë sukses jo vetëm gjatë viteve shkollore, por gjatë gjithë jetës.

Bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet ka efekt mjaftë pozitiv, për t'i ndihmuar fëmijët lidhur me procesin mësimor gjatë viteve shkollore, për cilësinë e mësimdhënies, lidhur me mendimin e fëmijëve që kanë për shkollën, etj, (Joyce Epstein, 2001).

Bashkëpunimi shkollë-familje-komunitet ndihmon në përparimin e programeve mësimore dhe klimës në shkollë, krijon shërbime dhe i mbështet familjet, ndihmon prindërit në rolin drejtues dhe ndihmon mësuesit në lidhje me punën në shkollë. Bashkëpunimet e tilla krijohen për fëmijët për arsye që të kenë sukses në shkollë dhe jashtë saj. Prindërit konsiderohen si mësuesit e parë të fëmijës, dhe mësuesi konsiderohet si prindër i dytë i fëmijës. Prindërit dhe mësuesit kanë rol thelbësorë për edukimin e fëmijës, prindërit në shtëpi dhe mësuesit në shkollë. Prindërit dhe mësuesit duhet të krijojnë një marrëdhënie konstruktive në punë që sjellë dobi, që është shumë e nevojshme për edukimin e fëmijëve që edukohen në shkolla. Në shumë raste, arritjet e nxënësve në shkollë varen nga prindërit e tyre. Nëse prindërit janë të përfshirë në shkollë, arritjet e fëmijëve do të jenë më të larta.

Në librin e saj, të quajtur shkolla, familja dhe partneriteti në komunikim, Joyce Epstein (2001) thekson se shkolla, familja dhe komuniteti kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve dhe se zhvillimi arsimor i fëmijëve përmirësohet kur këta tre faktor bashkëpunojnë së bashku, drejt qëllimeve të përbashkëta. J.Epstein thekson se prindërit e nxënësve të shkollës fillore janë më të prirur të përfshihen në shkolla, krahasuar me prindërit e nxënësve të shkollës së mesme.

Një nga konceptet më të rëndësishme teorike të partneritetit dhe përfshirjes së prindërve në aktivitetet shkollore është tipologjia e dhënë nga Joyce Epstein (2001-2002), e cila ka gjashtë forma të përfshirjes së prindërve:

1. **Prindërimi si përgjegjësi themelore e familjes.** I referohet përgjegjësisë për të siguruar shëndetin dhe sigurinë e fëmijës. Prindërit krijojnë kushte të përshtatshme për t'i ndihmuar fëmijët e tyre gjatë shkollimit. Shkollat që bashkëpunojnë së bashku me prindërit u ofrojnë prindërve informacion bazë për fëmijët, sigurinë dhe shëndetin e tyre, mbikëqyrjen, disiplinën dhe aftësitë prindërore.

2. Vendosja e një komunikimi efektiv të dyanshëm ndërmjet familjes dhe shkollës. Shkolla u fokusua mbi programet shkollore dhe suksesin e nxënësve. Shumë shkolla u dërgojnë prindërve informacione për programin shkollorë dhe arritjet akademike të nxënësve (notat, mungesat, etj). Sigurisht, që këto informacione vijnë nga mësuesi i fëmijës, i cili informon prindërit. Kështu, prindërit janë të informuar lidhur me arritjet dhe sjelljen e fëmijëve në shkolla.
3. Dëshira për përfshirjen e prindërve në shkollë. I referohet prindërve vullnetarë që kanë dëshirë për ta mbështetur shkollën dhe nxënësit. Sipas këtij lloji të përfshirjes, shkolla njeh kapacitetin e prindërve, lidhur me kohën dhe burimet që i kanë në dispozicion, dhe i përfshin në përmirësimin e cilësisë së programeve shkollore dhe suksesit të nxënësve. Prindërit dhe individët tjerë që janë në komunitet, mundën të punojnë me dëshirën e tyre në shkolla, klasa dhe vende tjera.
4. Mësimdhënia si kod i shtëpisë, që merr pjesë në aktivitetet shkollore. Mësuesit i udhëzojnë prindërit se si të monitorojnë, ndihmojnë dhe si të marrin pjesë në mësimin e fëmijëve në shtëpi, aktivitete që lidhen me kurrikulën.
5. Vendimmarrja si pjesëmarrje dhe udhëheqje. Shkolla inkurajon pjesëmarrjen e prindërve në vendimmarrjen e shkollës, duke nxitur organizimin e shoqatave të prindërve, përfshirjen e prindërve dhe përfaqësuesit e komunitetit në bordet e shkollave.
6. Bashkëpunimi me komunitetin vendor. Ka të bëjë me harmonizimin e nevojave të ndërsjella të familjes, shkollës dhe komunitetit lokal. Shkolla lidhet me vetëqeverisjen lokale, institucionet e komunitetit, organizatat fetare, shoqatat kulturore, të moshuarit dhe grupet e tjera që ndajnë interes të përbashkët për edukimin dhe suksesin e nxënësve. (Epstein 2002, Sanders, 2001).<sup>1</sup>

Nga përfshirja e prindërve në shkollë, përfitime ka nxënësi, mësuesi edhe prindërit.

**Nxënësi-** krijon një qëndrim pozitiv rreth shkollës, përmirëson arritjet dhe sjelljen e tij në shkollë, u kushton më shumë kohë dhe kujdes detyrave të shtëpisë, rrit ndjenjën për të mësuar, nuk e braktis shkollën, është më i sigurtë, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi, etj.

**Mësuesi-** përmirëson marrëdhënien me prindërit, lehtëson punën e tij lidhur me kujdesin e nxënësve, i kupton më mirë nevojat e nxënësve në mësim, i din pikat e forta dhe të dobëta të nxënësve që ka në klasë, etj.

**Prindërit-** e vlerësojnë më tepër punën e mësuesve, kanë më shumë informacion për fëmijët e tyre, fëmijët e tyre bëhen më të suksesshëm në shkollë, etj.

---

<sup>1</sup> Marina Matejevic., Marija Jovanovic. (2017) "Ukljucenost roditelja u skolske aktivnosti", (F.11-14)

## **1.2. Ndryshimi dhe zhvillimi i marrëdhënies mësues-prind**

Marrëdhënia mësues-prind është një faktor ndikues në edukimin e mirë të fëmijës, megjithëse kjo marrëdhënie ka ndryshuar shumë, duke e krahasuar me vitet e mëparshme.

Prindërit kur përfshihen në shkolla, marrin ide të ndryshme nga mësuesit apo stafi i shkollës se si t'i ndihmojnë dhe mbështesin fëmijët e tyre që fëmijët të kenë sukses në shkolla, por gjithashtu prindërit me përfshirjen e tyre në shkollë mësojnë më shumë gjëra rreth programit akademik të shkollës. Sigurisht, që edhe fëmijët përfitojnë nga përfshirja e prindërve në shkollë, sepse si prindërit, ashtu edhe mësuesit fokusohen në zhvillimin e fëmijës, pra fëmija të arrijë t'i kuptojë mësimet hap pas hapi, duke mos i kaluar ato apo mos të mbesë mbrapa, sepse është e vështirë për fëmijët t'i kuptojnë dhe mësojnë ato më vonë.

Mësuesit dhe prindërit duan që t'i ndihmojnë fëmijët të avancojnë me mësimet.

Për zhvillimin e marrëdhënieve mësues-prind, janë bërë shumë studime të ndryshme, të cilat kanë ardhur në përfundimin se kjo marrëdhënie ndryshon me kohën.

Gjithashtu rezultatet e studimeve të kryera në vende të ndryshme të botës tregojnë se nënat janë më aktive dhe më të përfshira në shkolla, krahasuar me baballarët, ku shumica e tyre e kalojnë përgjegjësinë te nënat, që nënat të marrin informacion nga mësuesi për arritjet dhe suksesin e fëmijës së tyre.

Në vitet e fundit, ka pasur rritje lidhur me përfshirjen e prindërve në shkolla, sidomos nga viti 2020, deri në vitin 2022, gjatë periudhës pandemike të Covid-19, sepse nxënësit kanë bërë mësim online dhe kështu prindërit kanë luajtur rolin e mësuesit në shtëpi, duke i ndihmuar nxënësit me detyrat e shtëpisë, duke i ndihmuar t'i kuptojnë mësimet, etj.

Ndryshe nga koha e mëparshme, ku prindërit mendonin se mësuesit e kanë në dorë fëmijën e tyre, tani prindërit e marrin përgjegjësinë për fëmijën e tyre, duke pasur komunikim me dy drejtime dhe të vazhdueshëm me mësuesin e fëmijës lidhur me arritjet akademike, sjelljen, etj. Tani prindërit janë më shumë të përfshirë në edukimin e fëmijës dhe në veprimtarinë e përgjithshme të shkollës, janë më të angazhuar në procesin mësimor me qëllim që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre që t'i përmbushin qëllimet arsimore.

Prindërit angazhohen jo vetëm kur mësuesi organizon mbledhje apo në ngjarjet e shkollës, por edhe pa thirrjen e mësuesve, ku prindërit dalin vullnetarë në mbështetjen e fëmijës së tyre si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi. Gjithashtu shkollat në vitet e fundit e vlerësojnë më shumë kontributin e prindërve dhe konsultohen me ta për çështje të ndryshme.

Duke e krahasuar marrëdhënien mësues-prind të dekadës së fundit me dekadat e tjera, mund të themi se një nga faktorët më të rëndësishëm që ndihmon në krijimin e marrëdhënies është edhe teknologjia. Sigurisht, që teknologjia ka avancuar me kohën dhe sot mund të themi se jo vetëm mësuesit dhe prindërit komunikojnë me telefona, por edhe fëmijët. Kështu, një nga faktorët kryesorë i cili mund të bëjë më të thjeshtë mënyrën e komunikimit mes prindërit dhe mësuesit është telefoni. Sidomos në vitin 2022, ku teknologjia ka arritur në fazën kulminante, duke u ndikuar edhe nga pandemia Covid-19, ku bëri që mësimi të zhvillohet online dhe nxiti prindërit të krijojnë marrëdhënie të forta dhe të mira me mësuesit e fëmijëve të tyre dhe bëri që prindërit të komunikojnë me mësuesin përmes telefonave apo edhe paisjeve tjera (kompjuteri, etj).

Tani më shumë se kurrë, prindërit kanë më shumë mundësi të komunikojnë lehtësisht me mësuesit, sepse i kanë të gjitha kushtet, gjë që ka munguar në dekadat e mëparshme.

Në vitet e fundit, marrëdhënia mësues-prind ka ndryshuar edhe nga përgjegjësia, pra nuk është e njëjta siç ka qenë më parë. Tani përgjegjësinë më të madhe e ka mësuesi, sepse nëse nxënësit nuk kanë arritje të mira në shkollë, shumë prindër i qortojnë mësuesit, ndryshe nga vitet e mëparshme ku prindërit dhe mësuesit kanë qortuar fëmijën.

Gjithashtu kur bëhet fjalë për ndryshim, duhet të përmendet edhe pakësimi i dhunës ndaj fëmijëve, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi. Prindërit duke bashkëpunuar me mësuesit e kanë ndryshuar edhe mënyrën e ndëshkimit për fëmijën e tyre, krahasuar me vitet e mëparshme, ku si prindërit, ashtu edhe mësuesit, kanë përdorur dhunën fizike, kurse tani ka disa mënyra të lehta ndëshkimi, si prsh: prindëri në shtëpi i thotë fëmijës së tij që nëse nuk i bën detyrat, nuk do e shohësh televizionin, apo mësuesi në shkollë u thotë nxënësve në klasë që nëse nuk i bëjnë detyrat rregullisht, do të merrni notë të dobët, etj.

Gjithashtu prindërit luajnë rol kryesorë lidhur me fëmijët e tyre, duke marrë pjesë në aktivitetet shkollore. Duke marrë pjesë në aktivitetet shkollore, prindërit marrin informacion për arritjet dhe zhvillimin e fëmijës së tyre, gjithashtu edhe njohuri për aftësitë e fëmijës.

Kur fëmijët shohin prindërit e tyre duke marrë pjesë në aktivitetet e shkollës, ata krijojnë një lidhje konkrete mes shtëpisë dhe shkollës dhe mësojnë rëndësinë që ka shkolla.

Përfshirja e prindërve në shkolla mund të quhet e suksesshme nëse ajo përfshirje është aktive dhe e vazhdueshme, lidhur me edukimin e fëmijës së tyre, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi. Prindërit në shtëpi mund ta paraqesin përfshirjen e tyre nëse u qëndrojnë afër fëmijëve të tyre, duke i ndihmuar gjatë leximit, gjatë bërjes së detyrave të shtëpise apo duke folur me fëmijët për mësimet që kanë mësuar në shkollë, etj.

Në 2 vitet e fundit, shumë fëmijë e kanë ndjekur mësimin në distancë, duke bërë mësim online përmes televizionit apo programeve të ndryshme, si zoom, etj, ndërsa prindërit kanë qenë aktiv lidhur me komunikimin me mësuesit, duke i marrë detyrat e shtëpise për fëmijën, etj. Mësimi në distancë dhe online ka përforcuar më shumë komunikimin e prindërve me mësuesit dhe u ka mundësuar prindërve të kalojnë më shumë kohë me fëmijët e tyre. Por ka edhe të këqija në këtë situatë, ku sipas shumë prindërve fëmijët e tyre nuk e dëshirojnë mësimin në distancë dhe janë të pakënaqur, sepse u mungon ambienti i shkollës dhe sigurisht shoqëria.

Dëshira e fëmijëve për t'u rikthyer në bankat shkollore është plotësuar, sepse tani vazhdon mësimi i rregullt si më parë. Gjithashtu shkollat do të kenë marrëdhënie më të mira me prindërit nëse prindërit janë të përfshirë në shkollë, e cila është shumë pozitive për procesin e të mësuarit të fëmijëve.

J.Epstein paraqet tre faktor lidhur me zhvillimin e marrëdhënieve në mes prindërve dhe mësuesve, ata janë:

- 1) Detyrimet e ndara të prindërve dhe mësuesve.
- 2) Detyrimet e përbashkëta të prindërve dhe mësuesve dhe
- 3) Detyrimet e vazhdueshme të prindërve dhe mësuesve.<sup>2</sup>

**Faktori i parë,** thekson se shkollat dhe organizimet familjare duhet të drejtohen nga mësuesit dhe prindërit të cilët kanë qëllime të ndara dhe role të pavarura.

Marrëdhënia e fëmijëve me prindërit e forcon mirëqenien e tyre. Prindëri shumë herë duhet të luaj rolin e mësuesit në shtëpi në mënyrë që të nxisë të nxënin e fëmijës, duke lexuar tregime të ndryshme me fëmijët e tyre, duke biseduar me fëmijët për detyrat apo duke i përsëritur mësimet që kanë mësuar në shkollë, duke folur për hobia të tyre, për shoqërinë e tyre, etj.

Nëse prindërit komunikojnë me fëmijët për mësimet, fëmijët mësohen të dëgjojnë, të kuptojnë me vëmendje dhe të jenë më serioz. Fëmijët kur janë në shkollë më së shumti i besojnë mësuesit dhe kanë respekt për të, si kur i këshillon apo i qorton.

---

<sup>2</sup> Carol R.Keyes. (2000) "Parent-teacher partnership", (F.107)

Hyrja në shkollë për fëmijët është e vështirë, sepse ata “largoohen” nga shtëpia dhe hyjnë në një shoqëri tjetër më të madhe. Drejtuesi kryesorë në shkollë është mësuesi, ku do t’i udhëheqë, do t’i mësojë dhe do t’i edukojë që të fillojnë sa më mirë këtë kapitull të ri të jetës së tyre. Si përfundim, mund të them se mësuesi ka detyrë të merret me fëmijën kur fëmija ndodhet në shkollë, kurse prindërit merren me fëmijën e tyre, kur e kanë në shtëpi.

Ndryshe nga detyrimet e ndara në mes të prindërve dhe mësuesve, kemi **detyrimet e përbashkëta (Faktori i dytë)**, ku shkollat e vejnë theksin te bashkëpunimi mes prindërve dhe mësuesve dhe e mbështesin bashkëveprimin mes tyre. Bashkëpunimi prindër-mësues krijon një partneritet të fortë, duke kontribuar shumë në përparimin e suksesshëm lidhur me procesin mësimor dhe në rezultatet pozitive të saj. Edukimi i fëmijëve mund të përmirësohet shumë nëse prindërit e tyre bashkëpunojnë me mësuesit. Nëse prindërit bashkëpunojnë me mësuesit, mund të ndërtojnë një marrëdhënie të mirë dhe një mjedis mësimor të përshtatshëm, si në shtëpi, ashtu edhe në shkollë. Kështu, për këtë faktor mund të them se është shumë i rëndësishëm dhe këshillohet që të përdoret nga shumë prindër, në bashkëpunim me mësuesit.

**Faktori i tretë**, tregon se vitet e hershme të jetës së fëmijës janë shumë të rëndësishme dhe duhet t’u kushtohet shumë vëmendje në mënyrë që fëmijët të kenë sukses më vonë, kur të hyjnë rregullisht në shkollë, duke nisur nga kopshti, deri në shkollën fillore, ku qëndrimet për të mësuar stabilizohen. Këtu kemi një detyrim ndryshe nga dy rastet e para, lidhur me kontributin e prindërve dhe mësuesve për zhvillimin e fëmijëve. Shumica e prindërve fillojnë në shtëpi përgatitjen e fëmijës së tyre për shkollën, duke i mësuar fëmijët e tyre përvojat e para të të mësuarit, siç janë: shkrimi, leximi, llogaritjen, ngjyrosjen, lojra të ndryshme, etj. Prindërit të cilët nxisin fëmijët të përfshihen në aktivitete të ndryshme, ndihmojnë në gjetjen e talenteve në fusha të ndryshme. Gjithashtu duke mbështetur shkrim-leximin, llogaritjen apo aktivitetet e tjera të fëmijës, prindërit ndikojnë në zhvillimin e fëmijërisë së hershme.

Me futjen e fëmijës në shkollë, mësuesi merr rolin që ka bërë prindëri në shtëpi, duke e zgjeruar më shumë mësimin e këtyre aftësive. Për mësuesin është një sfidë edukimi i të gjithë nxënësve, i cili nëse do ta kryej me sukses, do të marrë lëvdatë edhe nga prindërit e tjerë. Prindërit e fëmijëve jashtë detyrës të shkollës komunikojnë me njëri-tjetrin ndërsa ata presin t’i marrin fëmijët e tyre. Kështu, nëse mësuesi bën diçka të mirë për nxënësit (u ndihmon ta kuptojnë mësimin kur kanë vështirësi, etj), ky lajm do të përhapet shpejtë dhe mësuesi do të marrë lëvdata të shumta. Kjo ndihmon në zhvillimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira mes mësuesve dhe prindërve, sepse të gjithë prindërit e duan një mësues të mirë për fëmijën e tyre, i cili u qëndron afër fëmijëve, duke i mësuar dhe edukuar ashtu siç duhet.

Mësuesit dhe prindërit kanë qëllim që t’i bëjnë nxënësit të aftë ta ndërtojnë të ardhmen e tyre pa ndihmën e kujt.

### **1.3. Faktorët që pengojnë përfshirjen e prindërve në shkollë**

Të gjithë prindërit kanë dëshirë që të përfshihen në shkollë që t'i mbështesin fëmijët e tyre që të arrijnë rezultate të larta në shkollë. Por jo të gjithë prindërit i kanë mundësitë të përfshihen në shkollë për arsye të shumë faktorëve të cilët i pengojnë apo i ndalojnë prindërit të krijojnë një marrëdhënie të mirë me mësuesit dhe shkollat. Gjatë përpjekjeve për të krijuar një marrëdhënie të mirë, mësuesit dhe prindërit mund të hasin pengesa të ndryshme që vështirësojnë krijimin e marrëdhënive të mira.

Studime të kryera në këtë fushë paraqesin disa faktor të cilët e pengojnë përfshirjen e prindërve në shkollë dhe nuk i lejojnë prindërit të marrin informacion për fëmijët e tyre nga mësuesit. Më poshtë, do të paraqes disa nga këta faktor të cilët e bëjnë të vështirë përfshirjen e prindërve në shkollë.

**Prindërit mendojnë se përfshirja e tyre nuk është e nevojshme-** Disa prindër i rrinë afër fëmijës së tyre sa janë në shtëpi deri në fillimin e shkollës fillore. Ata mendojnë se kur fëmija i tyre fillon shkollën, nuk kanë nevojë për ndihmë, sepse e kanë mësuesin e tyre që i ndihmon ata për detyrat, etj. Kështu, prindërit mendojnë se nuk kanë nevojë të përfshihen në shkollë.

**Koha-** Shumë prindër punojnë dhe për ta është e vështirë pjesëmarrja në aktivitetet shkollore. Pra, kufizimi i kohës është një nga faktorët që kufizon prindërit të përfshihen në shkollë. Në shumë vende, prindërit e fëmijës janë të angazhuar me punë të ndryshme dhe kështu nuk gjejnë kohë të mjaftueshme që të përfshihen në shkollë.

Këta prindër nuk kanë shumë informacion për fëmijët e tyre në lidhje me shkollën dhe e konsiderojnë mësuesin si udhërrëfyes i vetëm i fëmijëve të tyre, sepse edhe kur vinë në shtëpi prindërit janë të lodhur nga puna dhe nuk i kushtojnë shumë kohë aktiviteteve të fëmijëve lidhur me shkollën.

**Barriera gjuhësore-** Ka shumë prindër që janë emigrant në shtete të ndryshme dhe gjuha për ta është një pengesë e madhe, që i pengon ata të përfshihen në shkollë, pra prindërit nuk mundën të flasnin me mësuesin, sepse nuk e kuptojnë gjuhën që flet ai. Në disa raste, njëri nga prindërit e kupton gjuhën e atij vendi ku jetojnë dhe mundet të komunikojë me mësuesin dhe mundet të përfshihet në shkollë.

**Mungesa e njohurive dhe aftësive të prindërve-** Disa prindër nuk kanë nivel të lartë arsimor dhe për këtë arsye vendosin mos të përfshihen në shkollë, sepse ndjehen të turpëruar dhe mendojnë se nuk do t'i kuptojnë mësuesit të cilët do u japin informacion për arritjet akademike të fëmijëve të tyre. Pra, prindërit që nuk kanë pasur sukses të lartë në shkollë e shikojnë përfshirjen e tyre si negative, sepse kanë frikë nga programi mësimor apo gjuha për të komunikuar rrjedhshëm me mësuesit dhe për këtë arsye e shmangin përfshirjen në shkollë, (Flynn, 2007).

**Prindër në moshë të re-** Në disa vende, ka raste që prindërit e fëmijës janë martuar në moshë të re dhe u mungon eksperiencia prindërore që të përfshihen në shkollë. Këta prindër i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe mendojnë që fëmijën duhet ta edukojë mësuesi pa pasur nevojë të përfshihen prindërit. Në këto familje, janë gjyshërit të cilët u ndihmojnë prindërve që të kujdesën për fëmijët e tyre. Kështu, gjyshërit mundohen të përfshihen në shkollë dhe t'i ndihmojnë nipat dhe mbesat e tyre të arrijnë rezultate të larta akademike në shkollë.



**Prindër të divorcuar-** Ka raste që prindërit e fëmijës janë të divorcuar dhe përfshirja e tyre në shkolla bëhet më e vështirë, sepse fëmija qëndron herë te babai, herë te nëna dhe kështu prindërit e fëmijës nuk interesohen shumë të përfshihen në shkollë, por duan të kalojnë kohë me fëmijën e tyre, duke u argëtuar, duke bërë shëtitje, etj. Por ka raste që prindërit, edhe pse janë të divorcuar, mundohen të përfshihen në shkollë për qëllim që fëmija i tyre të ketë sukses si fëmijët e tjerë në shkollë.

**Statusi socio-ekonomik-** Familjet që kanë një status socio-ekonomik të ulët, e kanë më të vështirë të përfshihen në shkolla për shkak të disa faktorëve, siç janë: orari jofleksibël i punës, mungesa e burimeve, nuk kanë mundësi që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre për t'i siguruar materialet shkollore, etj.

**Shkollat-** Në disa raste, zakonisht në zonat rurale (fshatra), shkollat kanë nevojë për fonde për të funksionuar mirë. Fonde për të siguruar një ambient të përshtatshëm për nxënësit që të mësojnë. Por shumë herë qeveria e vendit nuk është në gjendje të sigurojë të gjitha nevojat e shkollave dhe kështu shumë shkolla lihen në dorë të prindërve për të siguruar nevojat shkollore që fëmijët e tyre të marrin edukimin e duhur. Kështu, shumë prindër refuzojnë të përfshihen në shkolla, sepse nuk mundën t'i sigurojnë shkollës nevojat që kërkon, për arsye të statusit socio-ekonomik të dobët.

**Drejtorët-** Në shumë shkolla ka drejtorë që janë të vjetër në kryesinë e shkollës, të cilët vazhdojnë të ecin sipas metodës së vjetër, që është “shkolla nuk ka nevojë për prindër”. Shumica e drejtorëve mund të mos e kenë të qartë konceptin “përfshirje e prindërve” dhe nuk janë trajtuar kurrë për të përmirësuar marrëdhënien shkollë-shtëpi, pra nuk dinë si t'i këshillojnë stafin e tyre për këtë çështje. Kështu, për shkak të drejtorëve dhe stafit të shkollës, shumë prindër nuk përfshihen në shkolla, sepse nuk u dërgohet ftesa për përfshirje apo komunikim.

**Mësuesit-** Në disa raste, përfshirjen e prindërve mund ta pengojë edhe mësuesi i cili nuk e kupton rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe efektet e përfshirjes së prindërve, që ka në arritjet e nxënësit dhe shpesh mësuesit besojnë se është humbje e kohës për të komunikuar me prindërit. Zakonisht mësuesit e rinj në detyrë nuk i kushtojnë rëndësi bashkëpunimit me prindër, sepse nuk e kanë përvojën e duhur dhe nuk dinë si t'i nxisin prindërit të përfshihen në shkolla.

**Konflikti me mësuesin-** Sigurisht se nuk ka gjithmonë marrëdhënie të mira mes mësuesit dhe prindërit. Ka prindër të cilët nuk e kuptojnë mësuesin apo anasjelltas. Disa prindër mund të mos ndajnë të njëjtat mendime si mësuesi i fëmijës së tyre, gjë e cila mund të çojë deri në konflikt mes tyre, prsh: disa prindër kanë punë dhe vetëm pasdite mundën të shkojnë në mbledhjet që organizon mësuesi, kurse mësuesi nuk e plotëson këtë kërkesë të prindërve dhe kështu mund të shkojnë deri te mosmarrëveshja me njëri-tjetrin. Nga kjo mosmarrëveshje ndikohet edhe fëmija, sepse mësuesi mund ta shikojë me një sy tjetër gjatë vlerësimit, etj.

**Komunikimi negativ-** Në çdo marrëdhënie, komunikimi është i rëndësishëm. Komunikimi është si një urë, që përcjell informacionin nga mësuesi, te prindëri dhe nga prindëri, te mësuesi. Shumica e prindërve theksojnë se janë thirrur nga mësuesit dhe drejtorët vetëm për çështjet negative që nxënësit shkaktojnë në shkolla, si prsh: për pengesë në orë mësimore, rrahje, thyerje e materialeve shkollore, etj, dhe sipas prindërve ky komunikim nuk promovon një marrëdhënie të mirë mes shkollës dhe familjes. Kështu, shumica e prindërve vendosin që mos të përfshihen në shkollë, por vetëm t'i këshillojnë fëmijët e tyre nga shtëpia.

**Familje e madhe-** Sipas studimeve, prindërit që kanë mbi tre ose katër fëmijë janë të prirur që mos të jenë shumë të përfshirë në shkollë. Prindërit përfshihen vetëm për fëmijën e parë dhe të dytë dhe pastaj e ulin nivelin e përfshirjes në shkollë. Shumica e prindërve e kalojnë përgjegjësinë e tyre të fëmija i parë (nëse është i madh në moshë) që ai të përfshihet në shkollë dhe të komunikojë me mësuesin, për vëllezërit dhe motrat e tij.

**Vendbanimi-** Shumë shkolla janë larg nga vendi ku jetojnë familjet dhe një nga faktorët se pse prindërit nuk përfshihen në shkollë është edhe vendbanimi, sepse ndodhën larg shkollës dhe nuk kanë mundësi që të përfshihen. Disa prindër nuk kanë makina dhe për këtë arsye nuk përfshihen në shkollë dhe nuk shkojnë në shkollë rregullisht, por ndoshta një apo dy herë gjatë vitit shkollorë.

**Raca-** Në shumë shkolla ka fëmijë me raca të ndryshme, të cilët prindërit i çojnë në shkollë që të edukohen në mënyrë të barabartë si të gjithë nxënësit. Por, prindërit e nxënësve të cilët kanë raca të ndryshme nga të tjerët (prsh: në klasë ka shumë fëmijë dhe vetëm një apo dy janë me ngjyrë tjetër apo romë), në shumë raste nuk duan të përfshihen në shkollë, sepse mendojnë se prindërit e fëmijëve të tjerë pa ngjyrë mund t'i përqeshin apo bullizojnë gjatë mbledhjeve që organizon mësuesi në shkollë. Gjithashtu ata mendojnë se mësuesit nuk do të kenë marrëdhënie me ta, si me prindërit e tjerë dhe kështu shumë prindër me ngjyrë refuzojnë të përfshihen në shkollë.

Këta faktor shihen si ndikuesit kryesorë që pengojnë përfshirjen e prindërve në shkolla. Faktorët të cilët mund të pengojnë përfshirjen e prindërve në shkolla janë shumë, por unë kam folur vetëm për disa nga ata faktor, të cilët janë shumë të rëndësishëm. Shkollat funksionojnë më mirë nëse prindërit përfshihen në shkolla, sepse ata çka e mësojnë nxënësit në klasë e vazhdojnë me prindërit në shtëpi të tyre. Kështu, studime të ndryshme në këtë fushë theksojnë se shkollat dhe mësuesit duhet t'i nxisin prindërit që të përfshihen në shkollë, sepse përfshirja e prindërve në shkollë konsiderohet si një faktor kyç që ndikon në arritjet dhe sjelljen e nxënësve dhe nga përfshirja e prindërve sigurisht që do të përfitojnë edhe mësuesit dhe shkollat. Si përfundim, mund të them se shkollat dhe mësuesit duhet të bashkëpunojnë me të gjithë prindërit e fëmijëve njësoj, pa bërë diskriminim ndaj tyre.

#### **1.4. Faktorët që mundësojnë përfshirjen e prindërve në shkollë**

Përfshirja e prindërve në shkollë konsiderohet si një faktor i rëndësishëm, i cili mund të ketë ndikim pozitiv në edukimin dhe arritjet e fëmijës. Që mësuesi të ketë më shumë informacion për nxënësit që ka në klasë është e domosdoshme krijimi i një marrëdhënie të mirë me prindërit. Pra, mësuesi duhet t'i nxisë prindërit të përfshihen në shkollë, sepse do i ndihmojnë për të marrë më shumë informacion për nxënësit që ka në klasë. Tani do të paraqes disa faktor që mundësojnë përfshirjen e prindërve në shkollë.

**Efikasiteti i prindërve-** Sipas studimeve, edhe efikasiteti ndikon në përfshirjen e prindërve në shkollë. Prindërit që kanë një ndjenjë të lartë të efikasitetit lidhur me edukimin e fëmijës së tyre besojnë që do të ndikojnë në mënyrë pozitive në edukimin e tyre, nëse përfshihen në shkollë dhe kështu nuk hezitojnë të përfshihen, krahasuar me prindërit me ndjenjë të ulët të efikasitetit, që mendojnë se nuk do të ndikojnë në edukimin e fëmijës edhe nëse ata përfshihen në shkollë.

**Arsimi i prindërve-** Arsimi i lartë i prindërve, konsiderohet si një faktor që nxit prindërit të përfshihen në shkollë. Prindërit që kanë arsim të lartë, do të përdorin njohuritë e tyre për fëmijët e tyre, që ata të kenë arritje të larta akademike në shkollë. Edhe mësuesit preferojnë që këta prindër të përfshihen në shkollë, sepse mund të komunikojnë me ta, pa pasur problem për barriera gjuhësore (pra e kuptojnë njëri-tjetrin, edhe nëse flasin në gjuhën standarde).

**Mësuesi-** Sigurisht, që një nga faktorët që ndikon në përfshirjen e prindërve në shkollë është mësuesi. Mësuesi i cili e kupton rëndësinë e përfshirjes së prindërve sigurisht që do t'i ftojë prindërit të përfshihen në shkollë. Me përfshirjen e prindërve në shkollë, edhe mësuesi ndjehet më rehat, sepse nëse nxënësit shfaqin probleme në klasë lidhur me procesin mësimor, etj, mësuesi do të komunikojë me prindërit që t'i ndihmojnë fëmijët në shtëpi t'i kapërcejnë këto probleme.

**Teknologjia-** Teknologjia mund të rrisë dëshirën e prindërve që të përfshihen në shkollë. Nga viti 2020, me fillimin e pandemisë Covid-19, në shumë vende, shkollat kanë përdorur mjete të ndryshme teknologjike për të komunikuar me prindërit lidhur me detyrat e fëmijës, arritjet, suksesin, etj. Tani pothuajse të gjitha shkollat janë të varura nga teknologjia. Tani më shumë se kurrë, informimi i prindërve për fëmijët e tyre është me efikas përmes teknologjisë (përmes telefonit, kompjuterit, etj). Kështu, me ndihmën e teknologjisë, prindërit mund të përfshihen në shkollë në mënyrë aktive, pa qenë të pranishëm në mënyrë fizike në shkollë.

**Arritjet dhe sjellja e fëmijëve-** Shumë fëmijë mund të mos kenë arritje të larta dhe sjellje të mirë në shkollë deri sa prindërit e tyre vendosin të përfshihen në shkollë. Sigurisht, që nëse fëmijët nuk tregojnë sukses në shkollë, mësuesit i lajmërojnë prindërit dhe u tregojnë se është e rëndësishme që ata të përfshihen. Sigurisht, që prindërit kanë dëshirë që fëmija i tyre të jetë me i miri në shkollë dhe për këtë arsye vendosin të përfshihen që të përmirësojnë suksesin dhe sjelljen e fëmijës në shkollë.

**Klima e shkollës-** Klima e shkollës ka efekt në krijimin e marrëdhënies mësues-prind. Pra, është e rëndësishme që shkollat të jenë mjedise mikpritëse dhe të krijojnë besimin mes shkollës dhe familjes, me qëllim për të nxitur përfshirjen e prindërve në shkollë. Sigurisht, një klimë pozitive e shkollës ndikon në përfshirjen e prindërve në shkollë, por gjithashtu ajo ndikon edhe te nxënësit që të përmirësojnë arritjet akademike, sjelljen e tyre, dëshirën për mos ta braktisur shkollën, etj.

**Shkolla si mjedis mikpritës-** Nëse prindërit nuk ndjehen të mikpritur në shkollën e fëmijës së tyre, përfshirja do jetë e ulët. Kur prindërit ndjehen të mirëseardhur nga shkolla dhe u tregohet se çfarë roli kanë, ata nxitën dhe bëhen më të aftë që të përfshihen në shkollë dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Pra, shkolla luan rol të rëndësishëm në përfshirjen e prindërve, sepse nëse krijon një mjedis mikpritës, prindërit do të jenë më të përfshirë në shkolla.

Tani do të paraqes edhe disa strategji të ndryshme, të cilat duhet t'i përdor shkolla dhe mësuesit, me qëllim për të rritur përfshirjen e prindërve në shkolla.

**-Shkolla u ndihmon prindërve për të siguruar materialet e nevojshme të nxënësve.**

Disa shkolla për të rritur pjesëmarrjen e prindërve në shkolla, u ndihmojnë prindërve për të siguruar disa materiale kryesore për fëmijët e tyre. Pra, në shkollë, prindërit mund të marrin librat për fëmijët e tyre dhe t'i mbajnë deri në përfundim të vitit shkollorë. Pasi të përfundojë viti shkollorë, ata duhet t'i kthejnë librat dhe mund t'i marrin të tjerët për vitin pasardhës. Dhe kështu shumica e prindërve, sidomos ata me status ekonomik të ulët, ndihmohen nga shkolla dhe vendosin të përfshihen në shkollë.

**-Shkolla i fton prindërit për aktivitete të ndryshme.** Shkollat kanë edhe ditë të cilat së bashku me nxënësit ja kushtojnë aktiviteteve të ndryshme jashtëshkollore, siç janë: dita e shkollës, dita e pranverës dhe datat e tjera specifike, që nuk mbajnë orë të rregullta mësimore, por bëjnë aktivitete të ndryshme, ku nxënësit përgatiten të shfaqin disa aktivitete të ndryshme. Duke u dërguar ftesa prindërve, që edhe ata të jenë prezent në këto aktivitete, mësuesi rrit pjesëmarrjen e prindërve në shkolla.

**-Shkolla kërkon ndihmë nga prindërit.** Në disa raste, mësuesit dhe drejtorët i ftojnë prindërit të përfshihen në shkolla, për t'u ndihmuar me përmirësimin e infrastrukturës së shkollës, si prsh: lysterja, pastrimi, ndërtimi i disa objekteve, vurja e pemëve rreth shkollës, etj. Prindërit jo vetëm që përfshihen në procesin mësimor të fëmijës, por ndihmojnë edhe në rregullimin e shkollës, me qëllim që fëmija i tyre të ndjehet i qetë dhe i sigurtë në shkollë.

**-Shkollat komunikojnë me prindërit lidhur me transportin e nxënësve.** Disa shkolla që ndodhën në zonat rurale (fshatra) komunikojnë me prindërit për transportin e nxënësve. Prsh: drejtori u tregon prindërve që nëse doni që fëmijët tuaj të vinë në shkollë me autobus (makinë e madhe), duhet të paguani në fund të muajit disa të holla, ose nëse e bëni ju transportin e fëmijëve, do ju ndihmojmë ne me disa të holla në fund të muajit. Kështu, disa prindër vendosin të përfshihen në shkolla, duke e bërë transportin e fëmijëve të tyre vetë, duke u ndihmuar pak edhe nga shkolla.

**-Shkollat së bashku me prindërit zgjedhin përfaqësuesin e prindërve.** Disa shkolla dhe mësues u bëjnë thirrje prindërve që të përfshihen në shkollë, për të zgjedhur të gjithë se bashku përfaqësuesin e prindërve. Përfaqësuesi i prindërve është një prind i cili komunikon me prindërit tjerë për t'u treguar se kur janë mbledhjet (nëse nuk e kanë marrë ftesën nga mësuesi, etj) dhe i përfaqëson të gjithë ata prindër të cilët mungojnë në mbledhjet e organizuara nga mësuesi. Kështu, prindërit janë të përfshirë në shkollë, duke zgjedhur një përfaqësues i cili i ndihmon si prindërit, ashtu edhe mësuesit, duke mbledhur informacion nga ata prindër të cilët për disa arsye nuk mund të përfshihen në mënyrë aktive në shkollë dhe duke i treguar mësuesit në mbledhje informacionin e mbledhur, pra mendimet e prindërve.

Faktorët që ndikojnë në përfshirjen e prindërve në shkolla mundën të jenë shumë, por unë kam folur vetëm për disa faktor, që konsiderohen si më të rëndësishmit.

## **1.5. Komunikimi mësues-prind dhe format e komunikimit**

Përkufizimi i thjeshtë i komunikimit është ndarja e mendimeve, informacioneve apo aftësive midis individëve, (Sever, 1998). Studimet tregojnë se përfshirja e prindërve në shkollë është një faktor shumë i rëndësishëm, i cili ndikon në përmirësimin e arritjeve dhe sjelljes së nxënësit. Lidhur me përfshirjen e prindërve, rol kryesorë ka edhe komunikimi, i cili ndihmon mësuesit që të rrisin numrin e përfshirjeve të prindërve në shkollë. Mësuesit dhe prindërit duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin, duke u fokusuar mbi qëllimet e përbashkëta të tyre, që janë zhvillimi dhe edukimi i fëmijës.

Komunikimi mësues-prind mund të fillojë që në ditën e parë që nxënësit fillojnë shkollën. Duke komunikuar rregullisht me prindërit, mësuesit mund të ndajnë informacione për punën dhe arritjet e nxënësve në shkollë. Gjithashtu, nëse nxënësit nuk arrijnë të kenë arritje të larta akademike, ose paraqesin sjellje të keqe në klasë, mësuesi me anë të komunikimit mund t'i informojë prindërit, me qëllim që të punojnë së bashku, që ta kthejnë nxënësin në rrugën e duhur, pra drejt suksesit. Nëse në marrëdhënien mësues-prind, ka besim mes palëve, atëherë edhe komunikimi do të jetë i hapur, pra kur mësuesit dhe prindërit kanë besim dhe respekt për njëri-tjetrin, ata do të flasin hapur për problemet e ndryshme që pengojnë prindërit të përfshihen në shkollë apo për ndonjë shqetësim që shfaqë fëmija gjatë mësimit në klasë apo në shtëpi, etj, me qëllim që të gjejnë zgjedhje të përbashkët, që t'i zgjedhin të gjitha problemet dhe shqetësimet e ndryshme.

Nga komunikimi mësues-prind sigurisht që përfitojnë edhe prindërit. Prindërit nuk janë gjithmonë të përfshirë drejtpërdrejt në shkollë, por nga komunikimi i rregullt me mësuesit, prindërit mund të kuptojnë se në cilat fusha lëndore i kanë fëmijët e tyre të suksesshëm dhe në cilat fusha fëmijët kanë vështirësi. Gjithashtu, mësuesit me anë të komunikimit i ndihmojnë prindërit që të ndjehen të vlerësuar dhe më të sigurtë drejt përfshirjes në procesin mësuesor. Përfitime nga komunikimi me prindërit ka edhe mësuesi, sepse prindërit mund t'i shërbejnë si ndihmës mësuesit, duke e ndihmuar fëmijën në shtëpi me detyrat apo mësimit që nuk arrijnë t'i kuptojnë në klasë apo duke i treguar mësuesit se ku ka vështirësi fëmija, me qëllim që mësuesi ta ndihmojë fëmijën t'i përmirësojë ato.

Sigurisht, që nga komunikimi mes mësuesit dhe prindërit ka përfitime edhe fëmija, sepse prindërit të cilët përfshihen në shkollë mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të përmirësojnë arritjet akademike dhe sjelljen e tyre në shkollë. Pra, prindërit të cilët e ndihmojnë fëmijën e tyre me detyrat e shtëpisë, e ndihmojnë të përgatitet kur ka teste në shkollë, etj, do ta çojnë fëmijën e tyre drejt arritjes së suksesit në shkollë.

Në shumicën e rasteve, fëmijët ndjehen të gëzuar që prindërit e tyre përfshihen në shkollë dhe nxitën të mësojnë më shumë, që të arrijnë sukses të lartë, për ta ndarë me prindërit e tyre, suksesin e tyre.

Komunikimi mes mësuesit dhe prindërit mund të jetë dy llojesh: **komunikimi me një drejtim dhe komunikimi me dy drejtime.**

**Komunikimi me një drejtim**- Është kur mësuesi i informon prindërit lidhur me aktivitetet apo ecurinë e nxënësve në shkollë. Te komunikimi me një drejtim, mësuesi i informon prindërit, duke përdorur komunikimin me shkrim, duke u dërguar mesazhe në e-mail, mesazhe telefonike, etj. Pra, lidhur me komunikimin me një drejtim, zakonisht mësuesi ka detyrë vetëm të mbajë prindërin të informuar lidhur me fëmijën e tij, duke mos marrë informacion mbrapa nga ai.

**Komunikimi me dy drejtime-** Ndryshe nga komunikimi me një drejtim, te komunikimi me dy drejtime kemi dialog mes mësuesit dhe prindërit. Mësuesit dhe prindërit mund të komunikojnë përmes bisedave telefonike, mbledhjeve në shkollë, vizitave në shtëpi, etj. Si qëllim kryesorë në komunikimin me dy drejtime janë kontaktet e vazhdueshme nga mësuesit dhe prindërit, nga biseda telefonike apo nga biseda në mbledhjet në shkollë, lidhur me arritjet e fëmijës, me qëllim që mësuesit dhe prindërit të bashkëpunojnë për ta dërguar fëmijën drejt suksesit. Me anë të komunikimit me dy drejtime, mësuesit dhe prindërit e kanë nën kontroll fëmijën, si në shkollë, ashtu edhe në shtëpi. Sigurisht, që nga viti 2020, është përdorur më shumë ky lloj i komunikimit, pra komunikimi me dy drejtime, sepse pandemia Covid-19 ka bërë që shumë shkolla të bëjnë mesimin online dhe kështu mësuesi ka komunikuar me prindërit nga telefoni lidhur me fëmijët, për të shikuar nëse i punojnë detyrat e shtëpise apo për të shikuar nëse mund të përshtatën fëmijët me mesimin online, etj.

Në vitet e mëparshme, mësuesit si formë të komunikimit me prindër kanë pasur mbledhjet në shkolla, duke u dërguar ftesa prindërve me qëllim që të komunikojnë bashkë. Kurse në vitet e fundit, sidomos nga viti 2020, kur pandemia Covid-19 mbizotërojë mbi botën, mësuesit dhe prindërit përdorin mjetet teknologjike (kompjuter, telefon, etj) që të komunikojnë së bashku. Prindërit dëshirojnë që forma e komunikimit me mësuesit të jetë me dy drejtime, pra të bëjnë dialog duke ndarë informacione të ndryshme për nxënësit, së bashku me mësuesit. Por ka edhe prindër të cilët nuk u intereson forma e komunikimit por duan që të përfshihen në shkollë dhe të krijojnë një marrëdhënie të mirë me mësuesin me qëllim që fëmija i tyre të ketë sukses të lartë dhe të ketë sjellje të mirë në shkollë.

Janë disa forma kryesore që bëjnë të mundur zhvillimin e komunikimit mes mësuesve dhe prindërve, të cilat do i paraqes më poshtë.

**Kontaktet telefonike-** Sot pothuajse çdo njeri ka telefon dhe kështu mësuesi mund të kontaktojë me prindërit përmes telefonit, gjë e cila përdoret shumë, sidomos nga viti 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, që ka kufizuar takimet në shkolla, duke bërë që komunikimi mes prindërve dhe mësuesve të bëhet vetëm nga mjetet teknologjike, ku një nga ato mjete është edhe telefoni. Por tani në vitin 2022, janë lehtësuar masat që janë marrë lidhur me covidin dhe tani mund të bëhen takime edhe në shkolla mes mësuesit dhe prindërit.

Komunikimi përmes telefonit mund të bëhet në dy forma:

1) **Kur prindërit telefonojnë mësuesin-** Në shumicën e rasteve shihet si jo e pëlqyer nga ana e mësuesve, sepse ka prindër të cilët mund të thërrasin mësuesin në momente të papërshtatshme, siç janë: gjatë orës mësimore, gjatë mbledhjeve me mësuesit e tjerë apo edhe gjatë kohës kur është me familjen e tij dhe mësuesi nuk mundet ta hapë telefonin.

2) **Kur mësuesi telefonon prindërit-** Edhe në këtë rast, kur mësuesit duan t'i telefonojnë prindërve, duhet të sigurohen nëse prindërit janë në shtëpi, sepse ka prindër të cilët mund të jenë në punë dhe mësuesit mund t'i shqetësojnë ata. Sigurisht, kur mësuesi telefonon prindërin, duhet të prezantohet si mësuesi i fëmijës, t'i pyes nëse është momenti i përshtatshëm për të folur, mos t'u marrë shumë kohë, por t'u tregojë vetëm gjërat kryesore për fëmijën, t'i dëgjojë me kujdes dhe t'u jap kohën e duhur për përgjigje, etj, me qëllim që biseda të jetë e kuptueshme nga ana e prindërve.

**Mbledhja me prindër në shkollë-** Konsiderohet si forma më e përdorur nga mësuesit që të realizojnë kontaktet e tyre me prindërit. Kjo formë e komunikimit vlerësohet edhe nga mësuesi, i cili gjatë mbledhjes ka qëllim që t'i informojë prindërit për ecurinë e fëmijëve të tyre në shkollë, t'u tregojë prindërve problemet që shfaqë fëmija i tyre në mësim, të dëgjojë mendimet e prindërve lidhur me programin e shkollës dhe së bashku të marrin vendime që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijëve. Kurse qëllimi i prindërve që marrin pjesë në mbledhje është të marrin informacion për arritjet akademike dhe për sjelljen e fëmijës së tyre, të dijë nëse fëmijët kanë vështirësi gjatë procesit mësimor, t'i tregojë mësuesit për vështirësitë që ka fëmija në shtëpi lidhur me mësimin, dhe të marrë më shumë informacion për metodat e të mësuarit që përdoren në shkollë.

Ka edhe forma tjera që mësuesi mund t'i përdor për të komunikuar me prindërit, siç janë: komunikimi përmes e-mailit, komunikimi përmes vizitave në shtëpi, etj, por unë kam folur për këto dy forma, të cilat konsiderohen si më të rëndësishmet dhe që përdoren pothuajse nga të gjithë mësuesit në shkollë, pra komunikimi me anë të telefonit dhe mbledhja me prindër në shkollë. Si përfundim, mund të them se mësuesi luan rol kryesorë për përfshirjen e prindërve në komunikimin mes njëri-tjetrit, sepse nëse mësuesi përdor format e komunikimit që prindërit i vlerësojnë dhe i pëlqejnë, do të ketë një numër të madh prindërisht të përfshirë në shkollë.

## **1.6. Arsyet e moskomunikimit dhe pengesat në marrëdhënien mësues-prind**

Marrëdhënia e mirë mësues-prind ndikon në përmirësimin e arritjeve akademike të nxënësve në shkollë, (Schussler, 2003). Sigurisht, për të krijuar një marrëdhënie të mirë rol kryesorë ka edhe komunikimi. Por krijimi i marrëdhënies mësues-prind nuk është gjithmonë e mundur, sepse në disa raste mund të ketë pengesa të ndryshme, të cilat ndikojnë negativisht në procesin e komunikimit mes mësuesit dhe prindërit.

Keqkomunikimi mes prindërve dhe mësuesve mund të ndodhë për disa arsye, siç janë: kontaktet e rralla me njëri-tjetrin, vendbanimi i prindërve larg nga shkolla, prindërit janë të painteresuar të përfshihen në shkollë, etj. (S.Christenson & J.Hirsch, 1998).

Si prindërit, ashtu edhe mësuesit theksojnë se mungesa e kohës është pengesa kryesore që pengon komunikimin mes mësuesit dhe prindërit.

Arsyet që pengojnë komunikimin mes prindërve dhe mësuesve mund të jenë të shumta, ku më poshtë do të paraqes disa arsye që janë me kryesoret.

**Besimi dhe roli i prindërve-** Besimi i prindërve lidhur me shkollën mund të jetë një pengesë e moskomunikimit mes mësuesit dhe prindërve. Mënyra se si prindërit e shohin rolin e tyre në shkollë (në edukimin e fëmijëve) mund të jetë vendimtare për prindërit nëse do të komunikojnë me mësuesit apo jo. Nëse roli i prindërve është vetëm t'i çojnë fëmijët e tyre në shkollë dhe t'i marrin kur të përfundojë mësimi, sigurisht që prindërit nuk do të dëshirojnë të përfshihen në shkollë apo të komunikojnë me mësuesit. Por nëse mësuesi u tregon prindërve se roli i tyre mund të jetë më i madh në shkollë, atëherë edhe prindërit duan të përfshihen në shkollë dhe të komunikojnë me mësuesin.

**Mendimi negativ i prindërit-** Ka prindër të cilët mendojnë se fëmija i tyre do të jetë i suksesshëm në shkollë edhe pa ndihmën e tyre dhe e shmangin komunikimin me mësuesin. Prindërit u bëjnë me dije fëmijëve në shtëpi se nëse nuk merrni rezultate të mira në shkollë, nuk do t'i plotësojmë dëshirat që ka fëmija, prsh: për të dalë në shëtitje, për t'u blerë ndonjë send, etj.

Ka raste që fëmija ja del të ketë sukses të kënaqshëm, edhe pse prindërit e tyre nuk komunikojnë vazhdimisht me mësuesin, por në shumicën e rasteve ky paragjykim i prindërve dështon, sepse fëmija nuk ka sukses të lartë në shkollë për shkak të moskomunikimit të prindërve me mësuesin e tij.

**Mosha e fëmijës-** Sigurisht, mosha e fëmijës mund të jetë një nga arsyet e moskomunikimit mes mësuesit dhe prindërit. Shumica e fëmijëve nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, e kanë prindërin e tyre aktiv dhe të përfshirë në shkollë, sepse fëmijët janë të vegjël dhe disa prindër mendojnë se do i kenë fëmijët më të suksesshëm, nëse komunikojnë me mësuesin e tyre. Por shumë fëmijë, kur kalojnë në klasën e gjashtë dhe më lart, nuk kanë dëshirë që prindërit e tyre të jenë të përfshirë në shkollë, sepse mendojnë se mund t'ia dalin vetëm, pa ndihmën e prindërve të tyre. Kështu, fëmijët kufizojnë përfshirjen e prindërve në shkollë, sepse shumica e prindërve e ndëgjojnë fëmijën e tyre dhe nuk vazhdojnë të komunikojnë në mënyrë aktive me mësuesin, por e lejnë fëmijën në dorën e mësuesit.

**Talenti i fëmijës jashtë fushës shkollore-** Një tjetër arsye që mund të shihet si pengesë për moskomunikimin mes mësuesit dhe prindërit është fëmija i cili është i talentuar në fusha të ndryshme, siç janë: sporti, muzika, aktrimi, etj. Kështu, prindërit nuk janë shumë të fokusuar që të komunikojnë me mësuesit apo të përfshihen në shkollë, sepse prindërit e mbështesin fëmijën në atë fushë që është i talentuar dhe ka më shumë sukses, sesa në shkollë.



**Sjellja negative e nxënësve në shkollë-** Sjellja jo e mirë e fëmijëve në shkollë mund të jetë një pengesë tjetër për moskomunikimin mes prindërve dhe mësuesit. Ka raste që prindërit nuk komunikojnë me mësuesin e fëmijës së tyre për arsye të sjelljes negative të fëmijës në shkollë. Kur fëmijët paraqesin sjellje jo të mirë në shkollë, përfshirja e prindërve në shkollë ulet, sepse nuk dëshirojnë që të marrin lajme të këqija për ta. Edhe kur mësuesit organizojnë mbledhje në shkollë me të gjithë prindërit, prindërit të cilët fëmijët e tyre paraqesin sjellje të keqe në shkollë, zakonisht mungojnë në mbledhje, sepse nuk dëshirojnë që të përqeshën nga prindërit e tjerë, apo të marrin kritika nga stafi i shkollës për fëmijën e tyre.

**Përvoja negative shkollore e prindërve-** Një pengesë për moskomunikimin mes prindërve dhe mësuesve mund të jetë edhe përvoja negative që kanë kaluar prindërit kur kanë qenë në shkollë, si prsh: sukcesi i dobët, sjellje jo e mirë, shkaktimi i problemeve të shumta në shkollë, përjashtimi nga shkolla, etj. Për këtë arsye, prindërit nuk dëshirojnë që të komunikojnë me mësuesin e fëmijës apo të krijojnë një marrëdhënie me të, sepse mendojnë se nëse përfshihen në shkollë, edhe fëmijët e tyre do të kenë përvojë negative, ashtu si prindërit e tyre. Këtu kemi të bëjmë më shumë me pengesë psikologjike, sepse prindërit paragjykojnë se përfshirja në shkollë do të ndikojë negativisht në suksesin dhe sjelljen e fëmijëve të tyre.

**Koha e pamjaftueshme e mësuesit për prindërit-** Një tjetër arsye që mund të pengojë komunikimin mes mësuesit dhe prindërit është koha e pamjaftueshme që mësuesi i kushton prindërve. Mund të ndodhë që gjatë mbledhjeve që organizon mësuesi në shkollë me prindërit, vendos ta mbajë mbledhjen vetëm 10 apo 15 minuta, vetëm sa t'i informojë prindërit për arritjet e nxënësve, duke kufizuar kohën e prindërve që të shfaqin opinionet e tyre. Shumica e mësuesve që janë të rinj në punë nuk u kushtojnë shumë kohë prindërve për të komunikuar me ta, pra nuk gjejnë kohë të informojnë prindërit për ecurinë e fëmijëve të tyre në shkollë. Shumica e prindërve kur shikojnë se mësuesit janë të paimterësuar për të komunikuar me ta apo nuk po u kushtojnë kohën e duhur, vendosin të shmangen nga shkollat dhe kështu shmangen edhe komunikimi mes mësuesve dhe prindërve.

Arsyet që pengojnë komunikimin mes mësuesit dhe prindërit janë të shumta, por unë kam paraqitur vetëm disa arsye, të cilat konsiderohen si më të rëndësishmet.

Si përfundim, mund të them se komunikimi i mirë mes mësuesit dhe prindërit mund të ndikojë pozitivisht në arritjet e nxënësve në shkollë. Duke e ditur këtë gjë, nëse mësuesi dëshiron të ketë komunikim të vazhdueshëm me prindërit, ai duhet të ketë sjellje pozitive kur të komunikojë me prindër, pavarësisht se si komunikon, me telefon, ballë-për-ballë, etj, duhet të jetë i sjellshëm me ta dhe mikpritës me qëllim që të fitojë besimin e tyre dhe t'i nxisë prindërit që të përfshihen në shkollë.

## 2.METODOLOGJIA E PUNIMIT

### 2.1. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit

Duke u bazuar në literaturën e shqyrtuar, u hartuan këto pyetje kërkimore dhe hipoteza për këtë hulumtim.

Pyetjet kërkimore janë:

1. Çfarë ndikimi ka komunikimi mësues-prind në arritjet shkollore të nxënësve?
2. A ndikon arsimi i të dy prindërve që nxënësit të kenë arritje të larta akademike?
3. Cilat janë arsyet më të shpeshta që mësuesit dhe prindërit komunikojnë së bashku?
4. Sa shpesh komunikojnë mësuesit dhe prindërit me njëri-tjetrin?
5. Cilat probleme hasin mësuesit dhe prindërit gjatë komunikimit me njëri-tjetrin?
6. Si e vlerësojnë mësuesit dhe prindërit komunikimin me njëri-tjetrin, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljes së nxënësve?
7. Cilat janë format e komunikimit më të dëshirueshme të mësuesve dhe prindërve që të komunikojnë me njëri-tjetrin?

Siç e shohim, kemi **shtatë (7) pyetje kërkimore**, për të cilat është dashur të marrë informacion nga mësuesit dhe prindërit e nxënësve të përzgjedhur për këtë studim.

Për këtë hulumtim, kam ngritur **dy (2) hipoteza**, të cilat kam mundur t'i testoj në shkollat e Tuzit, Sukruqit, Vuksanajve dhe Mileshtit.

Hipotezat janë:

1. Komunikimi i vazhdueshëm mësues-prind ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve.
2. Arsimi i prindërve ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve.

Unë kam supozuar se nxënësit të cilët kanë arritje të larta në shkollë, i kanë prindërit e përfshirë në shkollë, pra prindërit komunikojnë vazhdimisht me mësuesin.

Dhe nxënësit të cilët kanë arritje të larta në shkollë, i kanë prindërit e tyre me arsim të lartë, ose të mesëm.

## **2.2. Popullsia, kampionimi dhe përzgjedhja e rasteve**

Para fillimit të mbledhjes së të dhënave, kam marrë listën me të gjithë anëtarët e popullatës, në shkollën e Tuzit “Mahmut Lekiq”, pra listën e nxënësve, nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, për shkollën e Tuzit (vetëm për nxënësit që ndjekin arsimin në gjuhën shqipe), Sukruqit, Vuksanajve dhe Mileshtit. Lista e anëtarëve të popullatës përfshinte 346 nxënës, ku 169 ishin meshkuj dhe 177 ishin femra.

Në shkollën e Tuzit ka pasur 10 klasa, nga klasa e parë, deri në të pestën, duke i ndarë klasat në dy paralele, sepse numri i nxënësve është i madh, ku ndarja ishte: klasa e parë-1 dhe klasa e parë-2, klasa e dytë-1 dhe klasa e dytë-2, etj, kurse në shkollën e Sukruqit, Vuksanajve dhe Mileshtit ka pasur nga 5 klasa, nga klasa e parë, deri te klasa e pestë.

Duke mos pasur mundësi për të marrë informacion për të gjitha rastet, kam përdorur kampionimin sistematik për të marrë informacion për disa raste.

Kampioni përfshinte 58 nxënës, të cilët ishin objekt të analizës, ku informacionin për ta do e merrja nga mësuesit e tyre dhe prindërit e tyre.

Kam përdorur kampionin rastësorë të thjeshtë, duke u dhënë probabilitet të njëjtë të gjithë anëtarëve të popullatës që të përzgjedhen dhe të jenë pjesë e kampionit.

Kampioni ishte përfaqësues i të gjithë popullatës.

Kampioni i përmbushte kriteret shkencore, sepse qëllimi ishte marrja e informacionit për nxënësit e përzgjedhur në kampion, me anë të pyetësorëve, nga mësuesit dhe prindërit e tyre.

Përzgjedhja e rasteve u bë në mënyrë rastësore, duke pjesëtuar totalin e anëtarëve të popullatës, që ishte 346, me numrin e anëtarëve që doja të kisha në kampion, që ishte 60.

Nga pjesëtimi, rezultati ishte 5,7, por unë mora numrin 6, pra duke përzgjedhur çdo të 6-in anëtarë të popullatës në mënyrë rastësore. Përzgjedhja u bë kështu: nga 1 deri në 6, kam zgjedhur një numër rastësorë (anëtari i parë i kampionit), nga 7 deri në 12, kam zgjedhur një numër rastësorë (anëtari i dytë i kampionit), e kështu me rradhë, deri te rasti i fundit që ishte numri 346, anëtari i 58 i kampionit.

Duke përzgjedhur çdo të 6-in rast, numri i anëtarëve të kampionit ishte 58, sepse dy rastet e fundit nuk u mundën të përzgjedhen, sepse numri i përzgjedhjeve kalon numrin e anëtarëve të popullatës, që ishte 346.

Në dy tabelat më poshtë do të paraqitet: totali i mësuesve, totali i nxënësve, sa janë meshkuj dhe sa janë femra, si dhe totali i rasteve që janë përzgjedhur për kampion.

Gjithashtu do të paraqes edhe inicialet e mësuesve, nga klasa e parë, deri tek e pesta, për shkollat e Tuzit, Sukruqit, Vuksanajve dhe Mileshtit, së bashku me numrin total të nxënësve, për së cilën klasë dhe numrin e nxënësve në ditarë, që janë të përzgjedhur në mënyrë rastësore, që të jenë pjesë e studimit.

<b>Totali i mësuesve</b>	<b>Totali i nxënësve</b>	<b>Meshkuj</b>	<b>Femra</b>	<b>Totali i rasteve të përzgjedhura</b>
<b>25</b>	<b>346</b>	<b>169</b>	<b>177</b>	<b>58</b>

*Tabela 1. Totali i mësuesve, i nxënësve, sa janë meshkuj dhe femra, dhe totali i rasteve të përzgjedhura për kampion*

Inicialet e mësuesit/es	Shkolla (vendi)	Klasa	Nr. i nxënësve	Nr. në ditarë i nxënësve të përzgjedhur			
D.C	Tuz	E parë-1 (1-1)	20	4	7	15	
M.G	Tuz	E parë-2 (2-1)	22	3	8	13	20
H.D	Sukruq	E parë (1)	8	4			
S.I	Vuksanaj	E parë (1)	13	2	8		
S.B	Milesh	E parë (1)	12	1	7		
S.GJ	Tuz	E dytë-1 (2-1)	22	2	6	12	19
SH.D	Tuz	E dytë-2 (2-2)	15	3	9		
A.GJ	Sukruq	E dytë (2)	16	1	6	12	
M.L	Vuksanaj	E dytë (2)	8	4			
A.L	Milesh	E dytë (2)	12	1	6		
L.D	Tuz	E tretë-1 (3-1)	15	2	7	12	
L.C	Tuz	E tretë-2 (3-2)	11	1	8		
A.D	Sukruq	E tretë (3)	16	4	10		
SH.GJ	Vuksanaj	E tretë (3)	9	2	6		
S.DJ	Milesh	E tretë (3)	14	3	7		
L.J	Tuz	E katërt-1 (4-1)	18	1	7	13	
L.L	Tuz	E katërt-2 (4-2)	12	3	8		
A.C	Sukruq	E katërt (4)	10	1	6		
D.C	Vuksanaj	E katërt (4)	7	2			
S.GJ	Milesh	E katërt (4)	13	2	8		
K.L	Tuz	E pestë-1 (5-1)	16	1	7	14	
N.B	Tuz	E pestë-2 (5-2)	18	4	9	16	
S.I	Sukruq	E pestë (5)	9	2	8		
K.L	Vuksanaj	E pestë (5)	17	6	13		
Š.Đ	Milesh	E pestë (5)	13	2	7	13	
			<b>346</b>	<b>58</b>			

Tabela 2. Inicialet e mësuesve, vendodhja e shkollës, klasat, numri total i nxënësve në klasa dhe numrat në ditarë të nxënësve të përzgjedhur për studim

### **2.3. Metodatat, teknikat dhe instrumentet e kërkimit shkencor**

Lidhur me metodologjinë, kërkimi është sasior (kuantitativ) dhe ka drejtim pozitivist.

Për sa i përket teknikës së mbledhjes së të dhënave, kam përdorur pyetësorët për të mbledhur informacionin për nxënësit të cilët ishin objekt i analizës, por informacionin për ta e kam marrë nga mësuesit dhe prindërit e tyre.

Instrumentet e mbledhjes së të dhënave janë pyetësorët. Për këtë studim janë përdorur 3 (tre) pyetësorë: i pari për mbledhjen e opinionëve të mësuesve, i dyti për mbledhjen e informacionit për nxënësit (i plotësuar nga mësuesit) dhe i treti për mbledhjen e opinionëve të prindërve.

2 (Dy) pyetësorët për mësuesit dhe prindërit që kam përdorur për këtë studim, i kam marrë nga Hoover-Dempsey (2005), "The social context of parental involvement: A path to enhanced achievement", faqe 108, dhe nga Ardian Tana (2015), "Komunikimi mësues-prind dhe ndikimi i tij në arritjet e nxënësve", faqe 161-172, i cili po ashtu ka marrë pyetësorët për studimin e tij nga autori Hoover-Dempsey (2005), por i ka modifikuar duke shtuar dhe hequr disa pyetje, ashtu si unë. Të dy pyetësorët i kam modifikuar, duke i hequr disa pyetje që nuk lidheshin me pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit tim dhe duke hequr disa pyetje të hapura, pyetje ku mësuesit dhe prindërit duhej të argumentonin përgjigjet e tyre me shkrim, sepse te studimet e tjera (të 2 autorëve që përmenda), zakonisht këto pyetje të hapura kishin mbetur pa përgjigje.

Te pyetësori i mësuesve, kam hequr 4 pyetje dhe i kam shtuar te pyetësori i dytë i mësuesve, që e kam formuluar unë, ku bëhej fjalë për të dhënat e nxënësve, siç janë: suksesi, sjellja e nxënësve dhe për mbledhjet që ka organizuar mësuesi në shkollë dhe për ardhjen e prindërve të nxënësve të përzgjedhur në mbledhjet e organizuara nga mësuesi në shkollë, dhe cili prind ka ardhur në mbledhje, që ishte pyetësori kryesorë.

Pyetjet që kam shtuar te pyetësori i dytë i mësuesve, ku ishin edhe të dhënat e nxënësve janë: cilat janë arsytet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, cilat probleme hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, sa shpesh komunikojnë mësuesit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur dhe sa e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljes së nxënësve. Dhe kështu, përpos pyetësorit të parë të mësuesve, që ishte për të mbledhur opinionet e mësuesve lidhur me komunikimin me prindërit, u formua edhe pyetësori i dytë i mësuesve, ku bëhej fjalë për të dhënat e nxënësve të përzgjedhur për këtë studim. Dhe te pyetësori i prindërve kam shtuar disa pyetje, siç janë: arsimit i babasë, arsimit i nënës, punësimit i babasë, punësimit i nënës, numri i fëmijëve që ka familja dhe sa e vlerësojnë prindërit shkollën për disa aspekte të ndryshme.

Pyetësorët janë të testuar se janë të besueshëm që të përdoren në kërkime, sepse faza e pilotimit është kryer nga studiues të tjerë që i kanë përdorur këta pyetësorë në studimet e tyre.

Studiuesit Hoover-Dempsey dhe Ardian Tana e kanë matur fazën e pilotimit të pyetësorëve, duke iu shpërndarë pyetësorët për ekspertizë (shqyrtim), disa mësuesve dhe prindërve, dhe pastaj disa pyetje i riformuluan dhe disa pyetje i hoqën, sepse ishin të pakuptueshme nga ana e prindërve dhe mësuesve. Gjithashtu këta studiues paraqesin një model të përdorshëm të shkallës Likert, të angazhimit të prindërve në proceset e shkollimit dhe të të nxënësve të fëmijëve. Duke u bazuar në llogaritjet për koeficientin cronbach alfa (alpha) që përdoret për matjen e besueshmërisë së pyetësorëve, këta studiues kanë arritur në konkluzionin se vlera e tyre ishte më e lartë se 0,74 (norma e lejuar). Kështu, studiuesit theksuan se pyetësorët konsiderohen të besueshëm dhe mundën të përdoren për kërkime të tjera.

Pyetëtori i parë i mësuesve është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të pyetëtorit, kemi disa informacione të përgjithshme të mësuesve, siç janë: mësues i cilës klasë jeni, gjinia, vendodhja e shkollës dhe sa nxënës keni në klasë. Kurse pjesa e dytë e pyetëtorit ka të bëjë me opinionet e mësuesve për komunikimin me prindërit, ku ka 3 pyetje.

**Në pyetjen e parë**, janë disa pohime të ndryshme dhe janë 5 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 4, alternativat janë: nuk e di (0), aspak dakord (1), disi dakord (2), dakord (3), shumë dakord (4).

**Pyetja e dytë**, është cilat janë format më të dëshirueshme të komunikimit me prindërit, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: aspak e pëlqyeshme (0), pak e pëlqyeshme (1), e pëlqyeshme (2), shumë e pëlqyeshme (3).

**Pyetja e tretë** dhe e fundit e pyetëtorit të parë të mësuesve është si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindër, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: aspak të dobishëm (0), disi të dobishëm (1), të dobishëm (2), shumë të dobishëm (3).

Pyetëtori i dytë i mësuesve është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të pyetëtorit, janë disa pyetje për të dhënat e nxënësve, siç janë: emri dhe mbiemri i nxënësve të përzgjedhur, gjinia, sjellja e nxënësve (si sillet në orë, a pengon gjatë orës, etj), suktesi i nxënësve për tre periudhat, niveli i sjelljes (frekuentimi në orë) për tre periudhat, numri i mbledhjeve me prindër, sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhjet që ka organizuar mësuesi në shkollë dhe cili prind ka ardhur në mbledhje. Kurse në pjesën e dytë të pyetëtorit, kemi bashkëpunimin me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, ku kemi 4 pyetje.

**Pyetja e parë**, është cilat janë arsyet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, me 6 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 5, alternativat janë: asnjëherë (0), tepër rrallë (1), rrallë (2), zakonisht (3), shpesh (4), shumë shpesh (5).

**Pyetja e dytë**, është sa shpesh komunikojnë mësuesit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: asnjëherë (0), 1 herë në dy muaj (1), 1 herë në muaj (2), çdo herë (3).

**Pyetja e tretë**, është cilat probleme hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, me 6 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 5, alternativat janë: asnjëherë (0), tepër rrallë (1), rrallë (2), zakonisht (3), shpesh (4), shumë shpesh (5).

Dhe **pyetja e katërt** dhe e fundit te pyetëtori i dytë i mësuesve është si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljes së nxënësve, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: aspak të dobishëm (0), disi të dobishëm (1), të dobishëm (2), shumë të dobishëm (3).

Pyetëtori i prindërve është i ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë të pyetëtorit, janë disa pyetje për të dhënat demografike apo informacionet e përgjithshme të prindërve, siç janë: klasa që ndjek fëmija, gjinia e fëmijës, prindëri që merret më shumë me çështjet shkollore të fëmijës, numri i fëmijëve që ka familja, personi që plotëson pyetëtorin, vendbanimi i prindërve, arsimi i prindërve dhe punësimi i prindërve. Në pjesën e dytë të pyetëtorit, kemi bashkëpunimin me shkollën, ku janë 3 pyetje.

**Pyetja e parë**, është sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre me mësuesin e fëmijës së tyre, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: aspak të përfshirë (0), të përfshirë me raste (1), të përfshirë (2), shumë të përfshirë (3).

Në **pyetjen e dytë**, kemi disa pohime të ndryshme, me 5 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 4, alternativat janë: nuk e di (0), aspak dakord (1), disi dakord (2), dakord (3), shumë dakord (4).

Dhe **pyetja e tretë** nga pjesa e dytë e pyetësorit është si e vlerësojnë prindërit shkollën për mikpritjen, menaxhimin e shkollës, komunikimin me mësuesit dhe drejtimin e shkollës, me 5 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 4, alternativat janë: shumë dobët (0), dobët (1), mjaftueshëm (2), mirë (3), shumë mirë (4).

Kurse pjesa e tretë dhe e fundit e pyetësorit të prindërve, ka të bëjë me format e komunikimit me mësuesit, me 3 pyetje. **Pyetja e parë**, është sa shpesh komunikojnë prindërit me mësuesit, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: asnjëherë (0), 1 herë në dy muaj (1), 1 herë në muaj (2), çdo herë (3).

**Në pyetjen e dytë**, kemi format e dëshirueshme të prindërve që të komunikojnë me mësuesit, ku kanë pasur të drejtën të përzgjedhin deri në 3 forma, dhe disa nga format e komunikimit janë: mbledhjet me prindër në shkollë, përmes telefonit, takimet brenda dhe jashtë shkollës, etj. **Pyetja e tretë** dhe e fundit e pyetësorit të prindërve është si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit, për sa i përket përfitimit që ka sjellë për fëmijën në nota, sjellje, etj, me 4 alternativa për të zgjedhur, me vlera numrike nga 0 deri në 3, alternativat janë: aspak të dobishëm (0), disi të dobishëm (1), të dobishëm (2), shumë të dobishëm (3).

Pyetësorët e mësuesve dhe të prindërve mund të shikohen tek aneksi, në faqën 72-80.

#### **2.4. Mbledhja e të dhënave**

Mbledhja e të dhënave nisi pasi u përzgjedhen rastet në mënyrë rastësore dhe pas fotokopijimit të pyetësorëve për mësuesit dhe prindërit.

Mbledhja e të dhënave u bë në shkollën e Tuzit, Sukruqit, Vuksanajve dhe Milesshit.

Mbledhja e të dhënave filloj me datën, 9 maj 2022, dhe zgjati deri me datën, 23 maj 2022, pra kohëzgjatja e mbledhjes së të dhënave ishte 2 javë.

Për mbledhjen e të dhënave kam përdorur pyetësorët, ku një pyetësorë ka qenë për prindërit e nxënësve të përzgjedhur dhe dy pyetësorë për mësuesit e nxënësve të përzgjedhur.

Pyetësorët për mësuesit u janë ndarë të gjithë mësuesve dhe i kanë plotësuar në shtëpi, kurse pyetësi për prindërit u është dhënë nxënësve të përzgjedhur (me ndihmën e mësuesve) për t'jua çuar prindërve të tyre që ta plotësojnë në shtëpi. Pasi e kanë plotësuar prindërit pyetësin, nxënësit e kanë sjellë te mësuesi i tyre.

Nga 25 mësues, 5 kanë refuzuar të jenë pjesë e studimit dhe kështu numri total i nxënësve të përzgjedhur për studim nga 58, bje në 48, sepse në ato 5 klasa ishin 10 nxënës për të cilët nuk kam marrë informacion. Nga 48 nxënës, 27 ishin meshkuj (56.25%), kurse 21 ishin femra (43,75%).

Edhe pse ishte probabiliteti pak më i madh për të përzgjedhur më shumë femra për studim, sepse nga 346 nxënës, 177 ishin femra dhe 169 ishin meshkuj, shohim se kam përzgjedhur më shumë meshkuj sesa femra.

Nga 48 prindër, 2 prindër kanë refuzuar të jenë pjesë e studimit, duke mos e plotësuar pyetësin.

Disa mësues dhe prindër nuk janë përgjigjur në të gjitha pyetjet që kanë pasur pyetësorët.



## **2.5. Analiza e të dhënave**

Analiza e të dhënave u bë pasi përfundojë mbledhja e të dhënave.

Të gjitha të dhënat e marra u hodhën në kompjuter, ku u bënë gati për analizën statistikore. Për ta bërë analizën statistikore të pyetësorëve, është përdorur programi SPSS 28.0 (Statistical Package for Social Scientists Software), i cili e ka bërë më të lehtë nxjerrjen e rezultateve të analizës së të dhënave.

Për opinionet e mësuesve lidhur me disa pohime, me arsyet se pse komunikojnë dhe problemet që hasin mësuesit gjatë komunikimit me prindër dhe për format e dëshirueshme të komunikimit me prindërit, u përdor metoda deskriptive (descriptive statistics) për të zbuluar se cili pohim është zgjedhur më shumë në formën tabelare dhe është përdorur programi excel për t'i paraqitur rezultatet në formë grafike, ku është përdorur grafiku me kolona.

Kurse për vlerësimin e komunikimit me prindër dhe kur komunikojnë mësuesit me prindërit, u përdor tabela e shpërndarjes së frekuencave (frequency) dhe grafikët me kolona të marra nga programi SPSS.

Gjithashtu për opinionet e prindërve lidhur me disa pohime, dhe se si prindërit e vlerësojnë shkollën, dhe për format e dëshirueshme të komunikimit me mësues, u përdor metoda deskriptive (descriptive statistics) në formë tabelare, duke e shoqëruar me grafikun me kolona, të marrë nga programi excel.

Kurse për vlerësimin e komunikimit me mësues dhe kur komunikojnë prindërit me mësuesit, u përdor tabela e shpërndarjes së frekuencave (frequency), duke e shoqëruar me grafikun me kolona, të marrë nga programi SPSS.

Për mbledhjet e organizuara nga mësuesi në shkollë dhe për ardhjen e prindërve në mbledhje, u përdor tabela e shpërndarjes së frekuencave (frequency). Gjithashtu për prindërin i cili merr pjesë më shumë në mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë, u përdor tabela e shpërndarjes së frekuencave (frequency), e shoqëruar me grafikun me kolona.

Për të dhënat e nxënësve, siç janë: gjinia, vendodhja e shkollës së nxënësve, klasa që ndjekin nxënësit dhe për suksesin e nxënësve në tre periudhat u përdor tabela e shpërndarjes së frekuencave (frequency) e shoqëruar me grafikun me kolona, kurse për gjininë e nxënësve dhe vendodhjen e shkollës së nxënësve u përdor grafiku tortë (pie chart).

Gjithashtu u përdor edhe korrelacioni i Pirsonit (Pearson Correlation) për të matur korrelacionin mes shkallës së suksesit të nxënësve për tre periudhat dhe sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje, dhe mes shkallës së suksesit të nxënësve për tre periudhat dhe shumës së arsimit të dy prindërve. Niveli i signifkancës te korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve për tre periudhat dhe shumës së arsimit të dy prindërve është në nivelin 0,05 (5%).

### 3.PARAQITJA E REZULTATEVE


#### 3.1. Të dhënat e nxënësve

Te të dhënat e nxënësve, do të paraqes në formën tabelare dhe me grafikë gjininë e nxënësve, vendodhjen e shkollës së nxënësve, klasën që ndjekin nxënësit dhe suksesin e nxënësve për tre periudhat. Gjithashtu do të flas edhe për sjelljen e nxënësve për tre periudhat (frekuentimi në orë). Do filloj me gjininë e nxënësve. Në këtë studim kemi 58 nxënës të përzgjedhur, por vetëm për 48 nxënës kam marrë informacion, ku 27 (56,25%) nga ata janë meshkuj, kurse 21 (43,75%) janë femra. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun tortë.

#### **Gjinia e nxënësve**

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative
Meshkuj	27	56.3
Femra	21	43.8
Total	48	100.0

Tabela 3. Shpërndarja e frekuencave të “gjinisë së nxënësve”




Grafiku 1. Gjinia e nxënësve

Për sa i përket vendodhjes së shkollës, 27 (56,25%) nxënës ndjekin shkollën e Tuzit në qytet, kurse 21 (43,75%) nxënës ndjekin shkollat e Sukruqit, Vuksanajve dhe Mileshtit në fshatra. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun tortë.

### Vendodhja e shkollës

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative
Fshat	21	43.8
Qytet	27	56.3
Total	48	100.0

Tabela 4. Shpërndarja e frekuencave të “vendodhjes së shkollës së nxënësve”




Grafiku 2. Vendodhja e shkollës së nxënësve

Lidhur me klasat që ndjekin nxënësit e përzgjedhur për këtë studim, në klasën e parë janë 12 (25%) nxënës, në klasën e dytë janë 10 (20,8%) nxënës, në klasën e tretë janë 11 (22,9%) nxënës, në klasën e katërt janë 5 (10,4%) nxënës dhe në klasën e pestë janë 10 (20,8%) nxënës. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Klasa që ndjekin nxënësit

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Klasa e parë	12	25.0	25.0
Klasa e dytë	10	20.8	45.8
Klasa e tretë	11	22.9	68.8
Klasa e katërt	5	10.4	79.2
Klasa e pestë	10	20.8	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 5. Shpërndarja e frekuencave të “klasave që ndjekin nxënësit”




Grafiku 3. Klasa që ndjekin nxënësit

Për sa i përket suksesit të nxënësve në periudhën e parë, nga 48 nxënës, 36 (75%) nxënës kanë sukses të shkëlqyer, 8 (16,7%) nxënës kanë sukses të shumë mirë dhe 4 (8,3%) nxënës kanë sukses të mirë. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Suksesi i nxënësve në periudhën e parë

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Mirë	4	8.3	8.3
Shumë mirë	8	16.7	25.0
Shkëlqyer	36	75.0	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 6. Shpërndarja e frekuencave të “suksesit të nxënësve në periudhën e parë”




*Grafiku 4. Suksesi i nxënësve në periudhën e parë*

Për sa i përket suksesit të nxënësve në periudhën e dytë, nga 48 nxënës, 36 (75%) nxënës kanë sukses të shkëlqyer, 9 (18,8%) nxënës kanë sukses të shumë mirë dhe 3 (6,3%) nxënës kanë sukses të mirë. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Suksesi i nxënësve në periudhën e dytë

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Mirë	3	6.3	6.3
Shumë mirë	9	18.8	25.0
Shkëlqyer	36	75.0	100.0
Total	48	100.0	

*Tabela 7. Shpërndarja e frekuencave të “suksesit të nxënësve në periudhën e dytë”*




*Grafiku 5. Suksesi i nxënësve në periudhën e dytë*

Për sa i përket suksesit të nxënësve në periudhën e tretë, nga 48 nxënës, 37 (77,1%) nxënës kanë sukses të shkëlqyer, 7 (14,6%) nxënës kanë sukses të shumë mirë dhe 4 (8,3%) nxënës kanë sukses të mirë. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Suksesi i nxënësve në periudhën e tretë

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Mirë	4	8.3	8.3
Shumë mirë	7	14.6	22.9
Shkëlqyer	37	77.1	100.0
Total	48	100.0	

*Tabela 8. Shpërndarja e frekuencave të “suksesit të nxënësve në periudhën e tretë”*



*Grafiku 6. Suksesi i nxënësve në periudhën e tretë*

Siç e shohim, në periudhën e tretë ka rritje për sa i përket suksesit të nxënësve, ku ka nxënës me sukses të shkëlqyer, më shumë se në dy periudhat e para. Nga kjo mund të them se nxënësit mësojnë më shumë në dy periudhat e fundit, me qëllim që kur të përfundojë viti shkollorë, të kenë sukses të shkëlqyer.

Për sa i përket sjelljes së nxënësve (frekuentimit në orë) për tre periudhat, të gjithë nxënësit kanë sjellje shëmbullore në të gjitha periudhat. Pra, të gjithë nxënësit nga klasa e parë, deri në klasën e pestë i ndjekin të gjitha orët mësimore dhe nuk kanë mungesa, pra sjellja e nxënësve nga klasa e parë, deri në klasën e pestë të shkollës fillore nuk ndikohet nga përfshirja e prindërve në shkollë. Duke parë se nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore, nga klasa e parë, deri në klasën e pestë janë aktiv në orët mësimore, mund të them se sjellja e nxënësve fillon të thyhet kur nxënësit kalojnë në klasën e gjashtë, deri te klasa e nëntë.

### 3.2. Opinionet e mësuesve për rëndësinë e komunikimit me prindërit

Tek opinionet e mësuesve për rëndësinë e komunikimit me prindërit, do të paraqiten opinionet e mësuesve që i kanë plotësuar në pyetësonin e parë dhe në pyetësonin e dytë.


Në **pyetësonin e parë**, kemi disa pohime lidhur me komunikimin me prindër, format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit dhe si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindër, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve.

Më poshtë do të shohim opinionin e mësuesve lidhur me disa pohime, të paraqitura në formën tabelare me formën deskriptive dhe me grafikun me kolona.

<b>Opinionet e mësuesve</b>						
	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Duhet të përmirësohet komunikimi mësues-prind	20	1	4	69	3.45	.826
Mësuesi duhet t'i përfshi prindërit kur nxënësit shfaqin probleme të sjelljes	19	3	4	70	3.68	.478
Përfshirja e prindërve duhet të nxitet nga shkolla	20	1	4	69	3.45	.826
Prindërit duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi	20	3	4	76	3.80	.410
Përfshirja e prindërve në çështjet e nxënësit sjellë më shumë probleme	20	1	4	31	1.55	1.099
Prindërit kanë vështirësi të kuptojnë problemet që hasin nxënësit	18	1	4	32	1.78	.878
Prindërit nuk kanë kohë të merren me problemet e fëmijës së tyre	19	1	4	29	1.53	.905
Prindërit nuk janë të interesuar për arritjet e fëmijës	19	0	4	28	1.47	1.073
Prindërve u mungon aftësia komunikuese	19	0	2	21	1.11	.459
Ekziston një klimë jobashkëpunuese mësues-prind	19	0	4	24	1.26	.806

Tabela 9. Statistika deskriptive e “opinionit të mësuesve”





*Grafiku 7. Opinionet e mësuesve*

Siç e shohim, shumica e mësuesve janë shumë dakord me pohimin se “prindërit duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë”.

Kurse shumica e mësuesve nuk janë aspak dakord me pohimin se “prindërve u mungon aftësia komunikuese”. Pra, mësuesit mendojnë se prindërit janë shumë komunikues dhe nuk kanë probleme me aftësinë komunikuese.

Lidhur me pyetjen se cilat janë format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit, shumica e mësuesve si formën shumë të pëlqyeshme kanë zgjedhur mbledhjet me prindër, pra mësuesit pëlqejnë që të komunikojnë me prindërit gjatë mbledhjeve të organizuara në shkollë.

Kurse si formën aspak të pëlqyeshme, shumica e mësuesve kanë zgjedhur vizitat në shtëpi, pra mësuesit nuk e pëlqejnë vizitën në shtëpi të prindërve për të komunikuar me prindër.


Më poshtë do të shohim format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit, të paraqitura në formën tabelare me formën deskriptive dhe me grafikun me kolona.

### Format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit

	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Mbledhjet me prindër	19	2	3	56	2.95	.229
Biseda telefonike	19	1	3	43	2.26	.653
Vizita në shtëpi	16	0	1	7	.44	.512
Nëpërmjet nxënësit	18	0	3	17	.94	.873
Komunikimi online (e-mail)	17	0	2	20	1.18	.728

*Tabela 10. Statistika deskriptive e “formave të dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit”*

## Format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit




Grafiku 8. Format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit

Dhe pyetja e fundit e pyetësorit të parë të mësuesve është se si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindër, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve. Nga 20 mësues, 18 kanë dhënë përgjigje, 2 nuk janë përgjigjur. Nga 18 mësues që kanë dhënë përgjigje, 17 (94,4%) mësues e vlerësojnë komunikimin me prindër shumë të dobishëm, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve, kurse vetëm 1 (5,6%) mësues e vlerëson të dobishëm komunikimin me prindërit. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindër, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve

	Fr. absolute	Fr. relative	% e vlefshme	Fr. komulative
Të dobishëm	1	5.0	5.6	5.6
Shumë të dobishëm	17	85.0	94.4	100.0
Total	18	90.0	100.0	
Mungo	2	10.0		
Total	20	100.0		

Tabela 11. Shpërndarja e frekuencave të "vlerësimit të komunikimit me prindër nga ana e mësuesit, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësit"



*Grafiku 9. Si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindër, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve*

Siç e shohim te tabela 11, kur ka ndonjë rast pa dhënë përgjigje, pra mungon përgjigja, përpos frekuencave absolute, relative dhe komulative, kemi edhe përqindjen (%) e vlefshme e cila merr përqindjen e rasteve që mungojnë dhe i shton te rastet aktive në tabelë.

Te **pyetësi i dytë**, kemi opinionin e mësuesve lidhur me arsyet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, sa shpesh komunikojnë mësuesit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, cilat prej problemeve hasin mësuesit gjatë komunikimit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur dhe si e vlerësojnë mësuesit komunikimin me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljen e nxënësit. Dhe në fund, do të paraqitet numri i mbledhjeve me prindër që kanë organizuar mësuesit në shkollë dhe numri i ardhjeve në mbledhje, nga ana e prindërve.

Them nxënësit e përzgjedhur, sepse këtu do të paraqitet opinioni i mësuesve, vetëm për 48 prindërit e nxënësve, që kam marrë informacion për ta nga mësuesit e tyre.

Lidhur me pyetjen se cilat janë arsyet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, arsyet më të shpeshta janë për “çështjet që kanë të bëjnë me arritjet e nxënësve”, pra për suksesin e nxënësve në shkollë, sepse si mësuesit, ashtu edhe prindërit duan që nxënësit të kenë sukses sa më të lartë gjatë viteve shkollore.

Kurse arsyeja për të cilën mësuesit komunikojnë më pak me prindërit e nxënësve të përzgjedhur është “çështja lidhur me mungesat e nxënësve në orë mësimore”. Këtu mund të them se pothuajse të gjithë nxënësit nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, në shkollën fillore janë aktiv në orët mësimore dhe nuk mungojnë. Nxënësit janë aktiv në orët mësimore, sepse janë të vegjël dhe kanë dëshirë të shkojnë në shkollë dhe kanë një mësues kujdestar i cili u mban shumicën e orëve mësimore, si prsh: gjuhën shqipe, matematikën, diturin natyre, etj, dhe kështu nxënësit janë në mbikëqyrje më të madhe nga mësuesi i tyre sesa kur kalojnë në klasën e gjashtë, deri në klasën e nëntë, ku pothuajse për të gjitha lëndët mësimore kanë mësues të ndryshëm. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare deskriptive dhe me grafikun me kolona.

### Arsyet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit

	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Çështje që kanë të bëjnë me arritjet e fëmijës në mësim	48	2	5	208	4.33	.930
Çështje që kanë të bëjnë me sjelljen e fëmijës	48	0	5	151	3.15	1.571
Çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien emocionale të fëmijës	48	0	5	134	2.79	1.584
Çështje që kanë të bëjnë me kurrikulën (ngarkesën mësimore, detyrat, etj)	48	0	5	172	3.58	1.200
Çështje që kanë të bëjnë me mungesën e nxënësve në orë mësimore	48	0	5	110	2.29	1.810

Tabela 12. Statistika deskriptive e “arsyeve më të shpeshta të mësuesve që komunikojnë me prindërit”




Grafiku 10. Arsyet më të shpeshta që mësuesit komunikojnë me prindërit

Lidhur me pyetjen se sa shpesh komunikojnë mësuesit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, kemi 5 mënyra të komunikimit, të cilat janë: mbledhjet mësues-prind, biseda telefonike, komunikimi online (e-mail), përmes aktiviteteve në shkollë dhe vizitave në shtëpi. Mësuesit kanë zgjedhur bisedën telefonike, si formën e komunikimit që komunikojnë çdo herë me shumicën e prindërve. Pra, mësuesit komunikojnë çdo herë me 33 (68.8%) prindër të nxënësve të përzgjedhur me anë të telefonit. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Biseda telefonike

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Asnjëherë	1	2.1	2.1
1 herë në dy muaj	3	6.3	8.3
1 herë në muaj	11	22.9	31.3
Çdo herë	33	68.8	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 13. Shpërndarja e frekuencave të “bisedës telefonike”




Grafiku 11. Biseda telefonike

Kurse si formën që nuk komunikojnë asnjëherë me prindërit, pothuajse të gjithë mësuesit kanë zgjedhur vizitën në shtëpi. Pra, mësuesit nuk komunikojnë asnjëherë me 47 (97,9%) prindër të nxënësve të përzgjedhur përmes vizitave në shtëpi. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

<b>Vizita në shtëpi</b>			
	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Asnjëherë	47	97.9	97.9
Çdo herë	1	2.1	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 14. Shpërndarja e frekuencave të “vizitës në shtëpi”




Grafiku 12. Vizita në shtëpi

Lidhur me pyetjen se cilat probleme hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindër, si problem kryesorë që ndodhë shumë shpesh, mësuesit kanë zgjedhur se “prindërit nuk u përcjellin informacion të vlefshëm, për pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës së tyre”. Kurse si problem që nuk ndodhë asnjëherë, mësuesit kanë zgjedhur se “prindërve nuk u interesojnë arritjet e nxënësve”. Pra, thënë ndryshe, prindërve u intereson shumë suksesi i fëmijëve të tyre. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare deskriptive dhe me grafikun me kolona.

### Problemet që hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindër

	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Nuk vijnë në mbledhje	48	0	5	31	.65	1.194
Nuk i kuptojnë problemet e fëmijës së tyre	48	0	4	34	.71	1.031
Prindërit nuk janë të interesuar për arritjet e fëmijës	48	0	5	17	.35	.887
Prindërit nuk bashkëpunojnë me shkollën	48	0	5	31	.65	1.280
Prindërit nuk përcjellin informacion të vlefshëm për pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës	48	0	5	40	.83	1.078
Prindërit nuk na mbështesin kur fëmijët e tyre shfaqin probleme në sjellje	48	0	4	23	.48	.967

Tabela 15. Statistika deskriptive e “problemeve që hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindër”




Grafiku 13. Problemet që hasin më shpesh mësuesit gjatë komunikimit me prindër

Pyetja e fundit e pyetësorit të dytë të mësuesve, ka të bëjë me vlerësimin e mësuesve lidhur me komunikimin me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljen e nxënësve. Mësuesit e vlerësojnë komunikimin të dobishëm me 4 (8,3%) prindër të nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljen e nxënësve, kurse shumë të dobishëm me 44 (91,7%) prindër të nxënësve të përzgjedhur. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

**Vlerësimi i komunikimit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur nga ana e mësuesve, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljen e nxënësit**

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Të dobishëm	4	8.3	8.3
Shumë të dobishëm	44	91.7	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 16. Shpërndarja e frekuencave të “vlerësimin të komunikimit nga ana e mësuesve me prindërit e nxënësve të përzgjedhur, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësit



Grafiku 14. Vlerësimi i komunikimit me prindërit e nxënësve të përzgjedhur nga ana e mësuesve, për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësit



Dhe në fund, do të paraqes në formën tabelare me frekuenca numrin e mbledhjeve që ka organizuar mësuesi në shkollë për tre periudhat dhe sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje.

### Mbledhjet që ka organizuar mësuesi me prindërit

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
3 mbledhje	25	52.1	52.1
4 mbledhje	8	16.7	68.8
5 mbledhje	7	14.6	83.3
6 mbledhje	7	14.6	97.9
7 mbledhje	1	2.1	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 17. Shpërndarja e frekuencave të “mbledhjeve që ka organizuar mësuesi me prindërit”

### Sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
2 herë	3	6.3	6.3
3 herë	23	47.9	54.2
4 herë	9	18.8	72.9
5 herë	7	14.6	87.5
6 herë	6	12.5	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 18. Shpërndarja e frekuencave të “ardhjeve të prindërve në mbledhje”

Siç e shohim, numri më i madh i mbledhjeve të organizuara nga mësuesit në tre periudhat me prindër është 7 mbledhje, kurse numri më i vogël i mbledhjeve të organizuara nga mësuesit është 3 mbledhje. Gjithashtu shohim se në 25 (52,1%) raste mësuesit kanë organizuar nga 3 mbledhje me prindër në tre periudhat, dhe vetëm në 1 (2,1%) rast mësuesi ka organizuar 7 mbledhje me prindër në tre periudhat.

Lidhur me ardhjen e prindërve në mbledhje, prindërit më së shumti kanë ardhur nga 3 (47,9%) herë në mbledhje, dhe më së paku nga 2 (6,3%) herë.

### 3.3. Opinionet e prindërve për rëndësinë e komunikimit me mësuesit

Tek opinionet e prindërve për rëndësinë e komunikimit me mësuesit, do të paraqiten opinionet e prindërve që kanë dhënë në pyetësorin e plotësuar nga ana e tyre.


Nga **pjesa e parë e pyetësorit të prindërve**, do të paraqiten disa informacione të përgjithshme për prindërit, siç janë: cili prindër merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës, personi që plotëson pyetësorin dhe arsimi i prindërve në formë tabelare dhe me grafikë. Do të paraqitet informacioni vetëm për 46 pyetësorët që i kanë plotësuar prindërit, nga 48 pyetësorë në total, sepse 2 prindër kanë refuzuar të jenë pjesë e studimit, duke mos e plotësuar pyetësorin.

Lidhur me pyetjen se cili prind merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës, nga 46 prindër, në 39 (84,8%) raste merret nëna, kurse në 7 (15,2%) raste merret babai. Pra, nënat janë më aktive lidhur me çështjet e shkollimit të fëmijës së tyre. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun tortë.

#### **Prindëri që merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës**

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative
Nëna	39	84.8
Babai	7	15.2
Total	46	100.0

Tabela 19. Shpërndarja e frekuencave të "prindërit që merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës"



Grafiku 15. Prindëri që merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës

Lidhur me pyetjen se cili person e plotëson pyetësozin, nga 46 prindër, kanë dhënë përgjigje vetëm 45 prindër, 1 prind nuk është përgjigjur se cili prind e ka plotësuar pyetësozin.

Nga 45 prindër, në 25 (55,6%) raste e ka plotësuar pyetësozin nëna, në 5 (11,1%) raste e ka plotësuar pyetësozin babai dhe në 15 (33,3%) raste e kanë plotësuar pyetësozin së bashku.

Shohim se nënat janë marrë më shumë me plotësimin e pyetësorëve.


Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

Duke munguar një rast, në tabelë kemi përqindjen (%) e vlefshme, që merr përqindjen e rastit që mungon dhe e shton te rastet aktive në tabelë.

### Personi që plotëson pyetësozin

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	% e vlefshme
Nëna	25	54.3	55.6
Babai	5	10.9	11.1
Së bashku	15	32.6	33.3
Total	45	97.8	100.0
Mungo	1	2.2	
Total	46	100.0	

Tabela 20. Shpërndarja e frekuencave të “personit që plotëson pyetësozin”




Grafiku 16. Personi që plotëson pyetësozin

Lidhur me arsimin e prindërve, për sa i përket arsimit të babait, nga 46 baballarë, 7 (15,2%) kanë arsim fillor, 29 (63%) kanë arsim të mesëm dhe 10 (21,7%) kanë arsim të lartë. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Arsimi i babait

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Fillor	7	15.2	15.2
I mesëm	29	63.0	78.3
I lartë	10	21.7	100.0
Total	46	100.0	

Tabela 21. Shpërndarja e frekuencave të “arsimit të babait”




Grafiku 17. Arsimi i babait

Për sa i përket arsimit të nënave, nga 46 nëna, 10 (21,7%) kanë arsim fillor, 22 (47,8%) kanë arsim të mesëm dhe 14 (30,4%) kanë arsim të lartë. Siç e shohim, kemi më shumë nëna që kanë arsim të lartë, krahasuar me baballarët e nxënësve të përzgjedhur për këtë studim. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Arsimi i nënave

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Fillor	10	21.7	21.7
I mesëm	22	47.8	69.6
I lartë	14	30.4	100.0
Total	46	100.0	

Tabela 22. Shpërndarja e frekuencave të “arsimit të nënave”



Grafiku 18. Arsimi i nënave


Në **pjesën e dytë të pyetësorit të prindërve**, do të paraqiten opinionet e prindërve, lidhur me bashkëpunimin me shkollën, ku do të shikojmë se sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre si prind me mësuesin e fëmijës së tyre, do shohim opinionin e prindërve për disa pohime të ndryshme dhe se sa e vlerësojnë prindërit shkollën lidhur me mikpritjen, menaxhimin e shkollës, komunikimin me mësuesit dhe drejtimin e shkollës. Opinionet e prindërve do të paraqiten në formën tabelare dhe me grafikë.

Lidhur me pyetjen se sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre si prind me mësuesin e fëmijës së tyre, nga 46 prindër, 1 (2,2%) prind është përgjigjur se ndjehet aspak i përfshirë, 9 (19,6%) prindër janë përgjigjur se ndjehen të përfshirë dhe 36 (78,3%) prindër janë përgjigjur se ndjehen shumë të përfshirë. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre si prind me mësuesin e fëmijës së tyre

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Aspak të përfshirë	1	2.2	2.2
Të përfshirë	9	19.6	21.7
Shumë të përfshirë	36	78.3	100.0
Total	46	100.0	

Tabela 23. Shpërndarja e frekuencave të “përfshirjes së prindërve në komunikimin e tyre si prind me mësuesin e fëmijës së tyre”



### Sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre si prind me ...

Grafiku 19. Sa të përfshirë ndjehen prindërit në komunikimin e tyre si prind me mësuesin e fëmijës së tyre

Tani do të paraqes opinionet e prindërve, lidhur me disa pohime me tabelën deskriptive dhe grafikun me kolona.

### Opinionet e prindërve


	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Prindërit duhet të kontaktojnë vazhdimisht me mësuesin e fëmijës së tyre	46	3	4	179	3.89	.315
Prindërit duhet të kenë marrëdhënie të mira me mësuesin	46	3	4	180	3.91	.285
Është detyrë e prindërve që të kontaktojnë shkollën për t'u informuar mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor	45	1	4	156	3.47	.842
Prindërit duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë	46	2	4	175	3.80	.453
Mësuesi ka për detyrë të kontaktojë prindërit për çdo problem që paraqet nxënësi	46	3	4	175	3.80	.401
Mësuesi duhet t'i zgjedhë vetë problemet me nxënësit	46	0	4	100	2.17	1.081
Fëmijët duhet t'i zgjedhin vetë problemet që kanë me mësuesit	46	1	4	85	1.85	1.074
Nuk është detyra e mësuesit të merret me problemet e nxënësit	46	0	3	56	1.22	.664

Tabela 24. Statistika deskriptive e “opinionit të prindërve”

Siç e shohim te shuma, prindërit janë shumë dakord me pohimin se “prindërit duhet të kenë marrëdhënie të mira me mësuesit”, pra prindërit dhe mësuesit duhet të komunikojnë vazhdimisht dhe të kenë marrëdhënie të mira.

Por prindërit nuk janë aspak dakord me pohimin se “nuk është detyra e mësuesit të merret me problemet e nxënësit”. Pra, prindërit mendojnë se mësuesi duhet të merret me problemet e fëmijës së tij, madje të bashkëpunojnë së bashku me prindërit që të gjejnë zgjedhje për problemet e ndryshme që i kanë nxënësit.

Më poshtë do të paraqitet edhe grafiku me kolona, i cili tregon me mirë se me cilin pohim prindërit janë shumë dakord dhe me cilin aspak dakord.



Grafiku 20. Opinionet e prindërve


Dhe lidhur me pyetjen e fundit, nga pjesa e dytë e pyetësorit se si e vlerësojnë prindërit shkollën për mikpritjen, menaxhimin e shkollës, komunikimin me mësuesin dhe drejtimin e shkollës, prindërit e vlerësojnë shumë mirë shkollën për sa i përket komunikimit me mësuesit, pra për mënyrën se si mësuesi e organizon mbledhjen në shkollë. Dhe e vlerësojnë dobët për drejtimin e shkollës, pra për mënyrën se si drejtohet shkolla nga drejtorët dhe stafi i shkollës. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare deskriptive dhe me grafikun me kolona.

### Si e vlerësojnë prindërit shkollën

	Pgj.	Min.	Max.	Shuma	Mesatarja	Devijimi std.
Si e vlerësojnë prindërit shkollën për mikpritjen dhe kontaktin	46	2	4	170	3.70	.511
Si e vlerësojnë prindërit shkollën për menaxhimin e shkollës	46	2	4	165	3.59	.541
Si e vlerësojnë prindërit shkollën për komunikimin me mësuesit	46	3	4	179	3.89	.315
Si e vlerësojnë prindërit shkollën për drejtimin e shkollës	46	2	4	163	3.54	.546

Tabela 25. Statistika deskriptive e “vlerësimit të shkollës nga ana e prindërve”





*Grafiku 21. Si e vlerësojnë prindërit shkollën*

Në **pjesën e tretë dhe të fundit të pyetësorit të prindërve**, kemi format e komunikimit mësues-prind, pra kemi pyetjet se sa shpesh komunikojnë prindërit me mësuesit, cilat janë format e dëshirueshme të prindërve për të komunikuar me mësuesit dhe si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit, për sa i përket përfitimit që ka sjellë për fëmijët në nota, sjellje, etj.

Lidhur me pyetjen se sa shpesh komunikojnë prindërit me mësuesit, kemi shtatë mënyra të komunikimit, ato janë: komunikimi me mësuesin përmes mbledhjeve që organizon mësuesi në shkollë, komunikimi me mësuesin përmes telefonit, komunikimi me mësuesin përmes e-mailit, takohem me mësuesin në shkollë, komunikimi me mësuesin përmes aktiviteteve që organizon shkolla, mësuesi bën vizita në shtëpi dhe komunikoj me mësuesin përmes eskursioneve me prindër dhe nxënës.


Në tabela do të paraqitet edhe përqindja (%) e vlefshme, sepse prindërit nuk kanë dhënë përgjigje për të gjitha format e komunikimit me mësuesit.

Prindërit kanë zgjedhur komunikimin me mësuesin përmes telefonit si formën që komunikojnë çdo herë me mësuesin, ku 39 (86,7%) prindër kanë zgjedhur se komunikojnë çdo herë me mësuesin përmes telefonit. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Prindërit komunikojnë me mësuesin përmes telefonit

	Fr. absolute	Fr.relative	% e vlefshme	Fr. komulative
1 herë në dy muaj	1	2.2	2.2	2.2
1 herë në muaj	5	10.9	11.1	13.3
Çdo herë	39	84.8	86.7	100.0
Total	45	97.8	100.0	
Mungo	1	2.2		
Total	46	100.0		

Tabela 26. Shpërndarja e frekuencave të “prindërve që komunikojnë me mësuesin përmes telefonit”



### Prindërit komunikojnë me mësuesin përmes telefonit

Grafiku 22. Prindërit komunikojnë me mësuesin përmes telefonit


Kurse si formën që nuk komunikojnë asnjëherë me mësuesit, prindërit kanë zgjedhur vizitat në shtëpi nga ana e mësuesve, ku 40 (87%) prindër e kanë zgjedhur si formën që nuk komunikojnë me mësuesit asnjëherë përmes vizitave në shtëpi nga ana e mësuesve.

Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

### Mësuesi bën vizita në shtëpi

	Fr. absolute	Fr. relative	% e vlefshme	Fr. komulative
Asnjëherë	40	87.0	90.9	90.9
1 herë në dy muaj	1	2.2	2.3	93.2
1 herë në muaj	1	2.2	2.3	95.5
Çdo herë	2	4.3	4.5	100.0
Total	44	95.7	100.0	
Mungo	2	4.3		
Total	46	100.0		

Tabela 27. Shpërndarja e frekuencave të “mësuesve që bëjnë vizita në shtëpi”



### Mësuesi bën vizita në shtëpi


Grafiku 23. Mësuesi bën vizita në shtëpi

Për sa i përket pyetjes se cilat janë format e dëshirueshme të prindërve që të komunikojnë me mësuesit, prindërit kanë pasur të drejtë të zgjedhin deri në 3 forma. Nga 45 prindër, 44 (32,6%) prindër kanë zgjedhur mbledhjet me prindër si formën më të dëshiruar të komunikimit me mësues, 38 (28,1%) prindër kanë zgjedhur bisedën telefonike si formën e dytë që dëshirojnë të komunikojnë me mësuesin dhe 25 (18,5%) prindër kanë zgjedhur takimet brenda dhe jashtë shkollës, si formën e tretë që dëshirojnë të komunikojnë me mësuesin. 1 prind nuk ka dhënë përgjigje për format e dëshirueshme të komunikimit me mësuesin. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare, ku kemi edhe përqindjen e rastit dhe me grafikun me kolona.

## Format e dëshirueshme të prindërve për të komunikuar me mësuesin

Format e komunikimit		Përgjigjet		Përqindja e rastit
		Zgj.	Përqindjet	
	Mbledhjet me prindër	44	32.6%	97.8%
	Përmes telefonit	38	28.1%	84.4%
	Nëpërmjet nxënësit	9	6.7%	20.0%
	Përmes e-mailit	0	—	—
	Takimeve brenda dhe jashtë shkollës	25	18.5%	55.6%
	Vizitave në shtëpi	0	—	—
	Pyetësorëve rreth opinionit të prindërve për probleme të ndryshme	2	1.5%	4.4%
	Përmes aktiviteteve që organizon shkolla	14	10.4%	31.1%
	Eskursioneve me prindër dhe nxënës	3	2.2%	6.7%
<b>Total</b>		<b>135</b>	<b>100.0%</b>	<b>300.0%</b>

Tabela 28. Format e dëshirueshme të prindërve për të komunikuar me mësuesin, me përqindje (%)



Grafiku 24. Format e dëshirueshme të prindërve për të komunikuar me mësuesin


Pyetja e fundit e pyetësorit të prindërve është se si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit, për sa i përket përfitimit që ka sjellë për fëmijët në nota, sjellje, etj.

Nga 45 prindër, 1 (2,2%) prind është përgjigjur se e vlerëson aspak të dobishëm komunikimin me mësuesin, 4 (8,9%) prindër e vlerësojnë të dobishëm komunikimin me mësuesin, dhe 40 (88,9%) prindër e vlerësojnë shumë të dobishëm komunikimin me mësuesin. 1 prind nuk ka dhënë përgjigje se sa e vlerëson komunikimin e tij me mësuesin. Më poshtë do të paraqitet në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

**Si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit, për sa i përket përfitimit që ka sjellë te fëmija i tyre në nota, sjellje, etj**

	Fr. absolute	Fr. relative	% e vlefshme	Fr. komulative
Aspak të dobishëm	1	2.2	2.2	2.2
Të dobishëm	4	8.7	8.9	11.1
Shumë të dobishëm	40	87.0	88.9	100.0
Total	45	97.8	100.0	
Mungo	1	2.2		
Total	46	100.0		

Tabela 29. Shpërndarja e frekuencave të “vlerësimit të komunikimit me mësuesit nga ana e prindërve”



**Si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit për sa i përket ...**


Grafiku 25. Si e vlerësojnë prindërit komunikimin me mësuesit, për sa i përket përfitimit që ka sjellë te fëmija i tyre në nota, sjellje, etj

### 3.4. Krahasimi i opinionit të mësuesve dhe prindërve në lidhje me komunikimin


Duke krahasuar format e dëshirueshme të komunikimit nga ana e mësuesve dhe prindërve me njëri-tjetrin, si mësuesit, ashtu edhe prindërit kanë zgjedhur mbledhjet në shkollë si formën më të dëshiruar që të komunikojnë së bashku. Pra, mësuesit dhe prindërit dëshirojnë që të komunikojnë me njëri-tjetrin përmes mbledhjeve që organizohen nga mësuesi në shkollë.

Kurse si formën që nuk dëshirojnë të komunikojnë së bashku si mësuesit, ashtu edhe prindërit kanë zgjedhur vizitat në shtëpi. Pra, mësuesit dhe prindërit nuk dëshirojnë të komunikojnë përmes vizitave në shtëpi, por përmes vizitave në shkollë.

Mund të them se mësuesit dhe prindërit kanë mendime të përbashkëta, lidhur me format e dëshirueshme të komunikimit me njëri-tjetrin. Më poshtë do paraqiten edhe një herë me grafikun me kolona, format e dëshirueshme të prindërve dhe mësuesve që të komunikojnë me njëri-tjetrin.



Grafiku 26. Format e dëshirueshme të prindërve për të komunikuar me mësuesin



Grafiku 27. Format e dëshirueshme të mësuesve për të komunikuar me prindërit

Ndërsa lidhur me pyetjen se sa shpesh komunikojnë mësuesit dhe prindërit me njëri-tjetrin, si mësuesit, ashtu edhe prindërit kanë zgjedhur bisedën telefonike si formën që komunikojnë çdo herë me njëri-tjetrin, kurse si formën që nuk komunikojnë asnjëherë bashkë, si mësuesit, ashtu edhe prindërit kanë zgjedhur vizitat në shtëpi.

Pra, mësuesit dhe prindërit komunikojnë më së shumti me njëri-tjetrin me anë të telefonit, lidhur me arritjet apo problemet e nxënësve, kurse nuk komunikojnë pothuajse asnjëherë përmes vizitave në shtëpi.


### 3.5. Prindi që merr pjesë më së shumti në mbledhjet në shkollë

Duke bashkuar se cili prind ka ardhur më shumë në mbledhjet e organizuara nga mësuesi në shkollë, në tre periudha, nga 48 prindër, rezultatet tregojnë se prindi që ka ardhur më shumë në mbledhje është nëna, pra në 32 (66,7%) raste ka ardhur nëna, kurse babai në 13 (27,1%) raste dhe të dy së bashku në 3 (6,3%) raste. Siç e shohim, rezultatet e këtij studimi tregojnë se nënat janë më shumë të përfshira në shkollë dhe komunikojnë më shumë me mësuesit e fëmijëve të tyre, krahasuar me baballarët, të cilët në këtë studim kanë rezultuar se nuk janë shumë të përfshirë në shkollë. Më poshtë rezultatet do të paraqiten në formën tabelare me frekuenca dhe me grafikun me kolona.

#### Prindi që merr pjesë më së shumti në mbledhje

	Frekuenca absolute	Frekuenca relative	Frekuenca komulative
Më shumë babai	13	27.1	27.1
Më shumë nëna	32	66.7	93.8
Së bashku	3	6.3	100.0
Total	48	100.0	

Tabela 30. Shpërndarja e frekuencave të “prindit që merr pjesë më së shumti në mbledhje”



Grafiku 28. Prindi që merr pjesë më së shumti në mbledhje



### **3.6. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje**

Korrelacioni përdoret për të matur fortësinë e korrelacionit mes dy variablave, pra korrelacioni na tregon nëse ekziston një marrëdhënie mes dy variablave, pra mes x-it (i pavarur, shkaku) dhe y-it (i varur, pasoja). Në këtë studim është përdorur korrelacioni i Pirsonit.

Së pari, kam matur shkallën e suksesit të nxënësve në tre periudhat dhe sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje, për të shikuar nëse ka korrelacion mes këtyre dy variablave.

Në këtë rast, variabli shkalla e suksesit të nxënësve është y-pasoja, pra variabel i varur dhe variabli ardhja e prindërve në mbledhje është x-shkaku, pra variabel i pavarur.

Rezultatet tregojnë se ka korrelacion të dobët pozitiv mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje, ku vlera e korrelacionit është 0,050 dhe niveli i signifkancës prej 0,734 tregon se marrëdhënia nuk është domethënëse. Pra, ka korrelacion mes këtyre dy variablave, por është i dobët pozitiv dhe jo domethënës. Mund të them se kjo vjen si pasojë se nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, në përgjithësi kanë sukses të shkëlqyer dhe të shumë mirë dhe nuk është se ndikohen shumë nga ardhja e prindërve të tyre në mbledhje.

Hipoteza e parë që kam ngritur nuk mundet të pranohet, e cila është “komunikimi i vazhdueshëm mësues-prind ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve”, edhe pse korrelacioni është pozitiv i dobët mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje. Më poshtë do të paraqitet korrelacioni mes dy variablave në formën tabelare.

#### **Korrelacioni**

		Shkalla e suksesit të nxënësve në tre periudhat	Sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje
Shkalla e suksesit të nxënësve në tre periudhat	Korrelacioni i Pirsonit	1	.050
	Sig. (2-tailed-bisht)		.734
	Totali	48	48
Sa herë kanë ardhur prindërit në mbledhje	Korrelacioni i Pirsonit	.050	1
	Sig. (2-tailed-bisht)	.734	
	Totali	48	48

*Tabela 31. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje*

### **3.7. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe shumës së arsimit të dy prindërve**

Së dyti, kam matur korrelacionin mes shkallës së suksesit të nxënësve në tre periudhat dhe shumës së arsimit të dy prindërve, për të shikuar nëse ka korrelacion mes këtyre dy variablave. Në këtë rast variabla shkalla e suksesit të nxënësve është y-pasoja, pra variabel i varur dhe variabla shuma e arsimit të dy prindërve është x-shkaku, pra variabel i pavarur.

Rezultatet tregojnë se ka korrelacion të mesëm pozitiv mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe shumës së arsimit të dy prindërve, ku vlera e korrelacionit është 0,303 dhe niveli i significancës është 0,041, gjë që tregon ekzistencën e një marrëdhënie domethënëse. Pra, ka korrelacion mes këtyre dy variablave dhe korrelacioni është i mesëm pozitiv. Shohim se korrelacioni i shkallës së suksesit të nxënësve dhe shumës së arsimit të dy prindërve është më i madh, sesa korrelacioni i shkallës së suksesit të nxënësve dhe ardhjes së prindërve në mbledhje. Kështu, mund të them se në shumicën e rasteve, nxënësit të cilët kanë të dy prindërit me arsim të lartë, janë më të prirur të kenë sukses më të lartë në shkollë, krahasuar me nxënësit të cilët i kanë prindërit me arsim të mesëm apo fillor.

Dhe në fund, mund të them se hipoteza e dytë që kam ngritur pranohet, e cila është “arsimi i prindërve ndikon pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve”, sepse korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve në tre periudhat dhe shumës së arsimit të dy prindërve është i mesëm pozitiv. Më poshtë do të paraqitet korrelacioni mes dy variablave në formën tabelare.

#### **Korrelacioni**

		Shkalla e suksesit të nxënësve në tre periudhat	Shuma e arsimit të dy prindërve
Shkalla e suksesit të nxënësve në tre periudhat	Korrelacioni i Pirsonit	1	.303*
	Sig. (2-tailed-bisht)		.041
	Totali	48	46
Shuma e arsimit të dy prindërve	Korrelacioni i Pirsonit	.303*	1
	Sig. (2-tailed-bisht)	.041	
	Totali	46	46

\*. Niveli i significancës është në nivelin 0.05 (2-tailed-bisht).

*Tabela 32. Korrelacioni mes shkallës së suksesit të nxënësve dhe shumës së arsimit të dy prindërve*

## **4.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

### **4.1. Përfundime**

Duke krahasuar informacionet që janë të paraqitura te literatura dhe të dhënat e mbledhura nga studimi i bërë, shikojmë se disa nga format e komunikimit që përmenden te literatura që janë të pëlqyeshme për mësuesit dhe prindërit, te studimi im, mësuesit dhe prindërit i vlerësojnë si format aspak të pëlqyeshme, për të komunikuar me njëri-tjetrin, siç janë: vizitat në shtëpi, komunikimi online me e-mail, etj. Kurse si format më të dëshirueshme të komunikimit mes mësuesve dhe prindërve me njëri-tjetrin, si te literatura, ashtu edhe nga rezultatet e studimit tim, janë: bisedat telefonike dhe mbledhjet në shkollë.

Gjithashtu te literatura theksohet se nënat janë më të përfshira në shkollë dhe po ashtu rezultatet e studimit tim, tregojnë se nënat janë më të përfshira në shkollë, krahasuar me baballarët.

Duke u bazuar te studimi i bërë, mund të them se shumica e nxënësve të ciklit të ulët të shkollës fillore nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, kanë sukses të lartë dhe sjellje shëmbullore, pra mësojnë mirë dhe i ndjekin të gjitha orët mësimore dhe nuk kanë mungesa.

Për suksesin e lartë dhe sjelljen shëmbullore të nxënësve, nga klasa e parë, deri në klasën e pestë, mund të them se ndikon edhe mësuesi (kujdestari), i cili u jep shumicën e lëndëve mësimore dhe i ka në mbikëqyrje nxënësit. Gjithashtu mund të them se nxënësit mësojnë më shumë në dy periudhat e fundit, me qëllim që në përfundim të vitit shkollorë, kur të marrin dftesën shkollore të kenë arritur rezultate të larta akademike.

Kur nxënësit kalojnë në klasën e gjashtë dhe deri në përfundim të shkollës fillore, mund të ketë ndryshime lidhur me suksesin dhe sjelljen e nxënësve, ku në disa raste mund të ketë edhe rënie.

Gjithashtu mund të them se mësuesit dhe prindërit komunikojnë me njëri-tjetrin më së shumti përmes mbledhjeve që organizon mësuesi në shkollë dhe përmes telefonit. Kurse më së paku ose aspak komunikojnë përmes vizitave në shtëpi, madje kjo është forma më pak e dëshiruar e komunikimit si nga mësuesit, ashtu edhe nga prindërit. Gjithashtu mësuesit dhe prindërit e vlerësojnë komunikimin me njëri-tjetrin shumë të dobishëm, për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore të nxënësve.

Dhe në fund mund të them se suksezi i nxënësve nuk ndikohet shumë nga ardhja e prindërve të tyre në mbledhjet e organizuara nga mësuesi në shkollë.

Kurse arsimi i të dy prindërve ndikon më shumë te suksezi i nxënësve, sepse shumica e nxënësve të cilët i kanë prindërit me arsim të lartë, kanë arritje më të larta akademike, krahasuar me nxënësit të cilët i kanë prindërit me arsim të mesëm apo fillor.

## **4.2. Kufizimet e kërkimit**

Kufizimet e kërkimit janë:

- literaturën që kam përdorur për këtë studim, nuk kam mundur ta gjej në biblioteka, por e kam marrë nga interneti,
- kampioni është i vogël dhe i kufizuar vetëm në Komunën e Tuzit, si i tillë, nuk mund të përfaqësojë të gjithë Malin e Zi. Arsyeja për të mos bërë një kampion më të madh është kosto e lartë financiare,
- ka pasur mësues që kanë refuzuar të marrin pjesë në studim,
- ka pasur mësues që nuk janë përgjigjur në të gjitha pyetjet e pyetësorëve,
- ka pasur prindër që nuk e kanë plotësuar pyetësorin, pra kanë refuzuar të marrin pjesë në studim,
- ka pasur prindër që nuk janë përgjigjur në të gjitha pyetjet e pyetësorit.

Ky hulumtim besoj se është i pari i bërë në Komunën e Tuzit (ndoshta edhe në Malin e Zi), që ka testuar nëse përfshirja e prindërve në shkollë dhe arsimit i prindërve ndikojnë pozitivisht në arritjet shkollore të nxënësve.

Ky studim mund të shërbejë si orientues për studimet e tjera të kësajë natyre, por me popullatë dhe kampion më të madh.

### **4.3. Rekomandime**

Siç e shikuar, komunikimi mes mësuesve dhe prindërve vlerësohet lartë nga ana e të dy palëve. Kështu, unë rekomandoj disa këshilla për prindërit dhe mësuesit për përmirësimin e marrëdhënies mësues-prind.

Për prindërit, mendoj se duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë dhe të përcjellin më shumë informacion për pikat e dobëta dhe të forta të fëmijës së tyre te mësuesit që edhe mësuesit t'i dinë ato, pra mësuesit t'i njohin më mirë nxënësit që i kanë në klasë me qëllim që të gjejnë zgjedhje së bashku me prindërit, për t'i forcuar apo përmirësuar ato.

Duke shkuar në mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë, të gjithë prindërit, si me arsim të lartë apo fillor, mendoj se mund të ndikojnë që fëmijët e tyre të kenë arritje të larta akademike në shkollë dhe kështu mësuesit dhe prindërit do të kenë marrëdhënie të mira dhe komunikim të vazhdueshëm me njëri-tjetrin.

Rekomandoj që edhe baballarët të jenë më të përfshirë në shkollë, sepse nga studimi i bërë rezultatet tregojnë, se nënat janë më shumë të përfshira, krahasuar me baballarët.

Gjithashtu për prindërit, mendoj se duhet të vazhdojnë të jenë të përfshirë në shkollë edhe kur fëmija i tyre kalon në klasën e gjashtë dhe në klasat më të larta, pra të vazhdojnë t'i mbështesin fëmijët edhe kur kalojnë në klasat më të larta apo në shkollë të mesme.

Kurse për mësuesit, mendoj se duhet të organizojnë më shumë aktivitete të ndryshme dhe t'i ftojnë prindërit që të jenë pjesë e atyre aktiviteteve me qëllim që të nxisin përfshirjen e prindërve në shkollë.

Mendoj se më mirë do të ishte nëse mësuesit i marrin numrat e të dy prindërve dhe të komunikojnë me të dy prindërit.

Gjithashtu mendoj se mësuesi duhet t'i tregojë prindërve për problemet që paraqesin fëmijët e tyre në shkollë apo jashtë saj, me qëllim që mësuesit të gjejnë zgjedhje së bashku me prindërit për përmirësimin e problemeve të ndryshme të nxënësve.

Dhe mendoj se mësuesit duhet të jenë më mikpritës dhe të nxisin përfshirjen e prindërve në shkollë.

Kurse për drejtorët dhe stafin e shkollave, mendoj se duhet ta drejtojnë dhe ta menaxhojnë më mirë shkollën, sepse shumica e prindërve nuk japin vlerësim maksimal për këto dy forma.

## BIBLIOGRAFIA

- Araceli Martinez. (2015) "Parent involvement and its affects on student academic achievement", *Core.ac.uk*.
- Alberto Abouchaar., Charles Desforges. (2003) "The impact of parental involvements parental support and family education on pupil achievement and adjustment", *Queen's Printer, Canada*.
- Carol R.Keyes. (2000) "Parent-teacher partnership", *Published by ERIC*.
- Daniel Ampem Darko-Asumadu., Solomon Sika-Bright., (2021) "Parental involvement and pupils academic performance in the Cape Coast Metropolis, Ghana", *Published by De Gruyter*.
- Eva Patrikakou. (2014) "Relationship among parents, students and teachers: The technology wild card", *Published by Elsevier Ltd*.
- Fatma Ozmen., Cemal Akuzum., Muhammed Zincirli., Gulenaz Selcuk. (2016) "The communication barriers between teachers and parents in primary schools", *Eurasian Journal of Educational Research*.
- Flynn V.Gregory (2007) "Increasing parental involvement in our school: The need to overcome obstacles, promote critical behaviors and provide teachers training", *Published by ERIC*.
- Guirong Li., Millie Lin., Chengfang Liu., Angela Johnson., Yanyan Li., Prashant Loyalka. (2019) "The prevalence of parent-teacher interaction in developing countries and its effect on student outcomes", *Published by Elsevier Ltd*.
- Ghfoor Abdul., Saudi Mushtaq. (2021) "Impacts of parents-teachers in teraction on the performance of student", *Published by ResearchGate*.
- Ibrahima Naite. (2021) "Impact of parental involvement on children's academic performance at crescent international school, Bangkok, Thailand", *IOP Conference series: Earth and environmental science*.
- Joyce L.Epstein., Mavis G.Sanders., Beth S.Simon., Karen Clark Salinas., Natalie Rodriguez Jansorn., Frances L.Van Voorhis. (2002) "School, family and community partnership", *Corwin press, INC. A sage publications company thousand oaks, California*.
- Kathleen V.Hoover-Dempsey., Joan M.T.Walker., Howard M.Sandler., Darlene Whatsel., Christa L.Green., Andrew S.Wilkins., Kristen Closson. (2005) "Why do parents become involved", *Published by JSTOR*.
- Laura Lara., Mahia Saracostti. (2019) "Effect of parental involvement on children's academic achievement in Chile", *Published by pubmed central, (PMC)*.
- Masa Djurusic., Mila Bunijevac. (2017) "Parental involvement as a important factor for successful education", *Journal of research on educational effectiveness*.
- Marina Matejevic., Marija Jovanovic. (2017) "Ukljucenost roditelja u skolske aktivnosti", *Published by ResearchGate*.
- Mathew A.Kraft., Shaun M.Dougherty. (2012) "The effect of teacher-family communication on student engagement: Evidence from a randomized field experiment", *Journal of research on educational effectiveness*.
- Ralpl B.McNeal Jr. (2014) "Parent involvement, academic achievement and the role of student attitudes and behaviors as mediators", *Universal journal of educational research*.
- Sara Rimm-Kaufman., Lia Sandilos. (2010) "Improving students relationship with teachers to provide essential supports for learning", *American psychological association*.

- Sabine Pirchio., Chiara Tritrini., Ylenia Passiatore., Traute Teaschner. (2013) “The role of the relationship between parents and educators for child behaviour and wellbeing”, *International journal about parents in education*.
- Schussler. (2003) “School as learning communities: Unpacking the concepts”, *Journal of school leadership*.
- S.Sever. (1998) “Language and communication”, *Ankara university education journal of the faculty of sciences*.
- S.Christenson., J.Hirsch. (1998) “Facilitating partnership and conflict resolution between families and schools”, *Semantic scholar*.
- S.Swap. (1993) “Developing home-school partnership: From concepts to practice” *Semantic scholar*.
- S.Wilder. (2014) “Effects of parental involvement on academic achievement: A meta-synthesis”, *Taylor and Francis an informa business*.

## ANEKS

Tek aneksi do paraqes dy pyetësorët e mësuesve dhe pyetësorin e prindërve.  
Tek pyetësori i dytë i mësuesve, me të dhënat e nxënësve, do të paraqes vetëm formën për një nxënës të përzgjedhur.

Universiteti i Malit të Zi

Studenti: Leon Dedvukaj  
[leon.dedvukaj@live.com](mailto:leon.dedvukaj@live.com)

Pyetësor për mësuesit

---

---

## PYETËSOR

*I nderuar koleg/e!*

Pyetësori ka për qëllim të marrë mendimin dhe qëndrimin tuaj në lidhje me përfshirjen e prindërve në shkollë dhe komunikimin e tyre me mësuesin. Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për hartimin e një studimi, i cili ka qëllim që të përmirësojë marrëdhënien shkollë-familje.

*Ju lutem të jepni përgjigje sa më të sakta.*

**Faleminderit për bashkëpunimin.**

### 1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM (Shëno me X alternativat që zgjedh)

<b>P1: Mësues i cilës klasë jeni?</b>	Klasës së _____
<b>P2: Gjinia</b>	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër
<b>P3: Vendodhja e shkollës</b>	<input type="checkbox"/> Qytet <input type="checkbox"/> Fshat
<b>P4: Sa nxënës keni në klasë?</b>	Në klasë kam _____ nxënës/e

### 2. OPINIONET TUAJA LIDHUR ME KOMUNIKIMIN ME PRINDËR.

**P2.1:** A jeni dakord me pohimet e mëposhtme? (Zgjedhni ju lutem alternativat sipas qëndrimeve tuaja personale)

Shumë dakord	Dakord	Disi dakord	Aspak dakord	Nuk e di
<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

Suksesi i komunikimit	1	2	3	4	0
Duhet të përmirësohet komunikimi mësues-prind	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mësuesi duhet t'i përfshi prindërit kur nxënësit shfaqin probleme të sjelljes	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfshirja e prindërve duhet të nxitet nga shkolla	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



Prindërit duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përfshirja e prindërve në çështjet e nxënësit sjellë më shumë probleme	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<b>Pengesat e komunikimit</b>					
Prindërit kanë vështirësi të kuptojnë problemet që hasin nxënësit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk kanë kohë të merren me problemet e fëmijës së tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk janë të interesuar për arritjet e fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërve u mungon aftësia komunikuese	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ekziston një klimë jobashkëpunuese mësues-prind	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P2.2:** Cilat janë format më të dëshirueshme të komunikimit me prindër?

Shumë e pëlqyeshme	E pëlqyeshme	Pak e pëlqyeshme	Aspak e pëlqyeshme
<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

<b>Format e komunikimit</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
Mbledhjet me prindër	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Biseda telefonike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vizita në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Nëpërmjet nxënësit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikimi online (e-mail)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P2.3:** Si e vlerësoni komunikimin me prindër për sa i përket ndikimit mbi arritjet dhe sjelljen e nxënësve?

- Shumë të dobishëm
  Të dobishëm  
 Disi të dobishëm
  Aspak të dobishëm

*“Pyetëtori i parë i mësuesve”*

Mësuesi/ja: , Shkolla (vendi): , Klasa e  
 Nxënësi i përzgjedhur:

Numri në ditarë	Emri dhe mbiemri i nxënësit/es	Gjinia
4		

Nëse e keni në fletorën tuaj, apo thjeshtë jepni mendimin tuaj edhe për nivelin e sjelljes së nxënësit/es të përzgjedhur në klasë apo jashtë saj (si sillet me shokët dhe shoqet, a pengon gjatë orës mësimore, etj). *Shëno me X alternativën që zgjedh.*

Numri në ditarë	Sjellje të mirë	Sjellje të keqe
4		

Suksesi i notave, niveli i sjelljes dhe mbledhjet me prindërit e nxënësit të përzgjedhur për tre periudhat

Suksesi i notave	Niveli i sjelljes (frekuentimi në orë)	Numri i mbledhjeve me prindër, sa herë kanë ardhur, dhe cili prind ka ardhur			
			Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë
Periudha e parë	Periudha e parë	Nr. i mbledhjeve			
		Sa herë kanë ardhur			
Periudha e dytë	Periudha e dytë	<i>Shëno me X për të treguar se kush ka ardhur</i>			
		Babai			
Periudha e tretë	Periudha e tretë	Nëna			
		Së bashku			

**BASHKËPUNIMI ME PRINDËR (Shëno me X alternativën që zgjedh)  
Për numrin 4 në ditarë (shëno emrin dhe mbiemrin e nxënësit/es te vizat boshe)**

**P1:** Cilat janë arsyet më të shpeshta që ju komunikoni me prindin/ërit e \_\_\_\_\_?

Shumë shpesh	Shpesh	Zakonisht	Rrallë	Tepër rrallë	Asnjëherë
<b>5</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
Çështje që kanë të bëjnë me arritjet e fëmijës në mësim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Çështje që kanë të bëjnë me sjelljen e fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien emocionale të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Çështje që kanë të bëjnë me kurrikulën (ngarkesën mësimore, detyrat, etj)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Çështje që kanë të bëjnë me mungesën e nxënësve në orë mësimore	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P2:** Sa shpesh komunikoni me prindin/ërit e \_\_\_\_\_?

<b>Komunikimi me prindër</b>	<b>1 herë në muaj</b>	<b>1 herë në dy muaj</b>	<b>Çdo herë</b>	<b>Asnjëherë</b>
Mbledhje mësues-prind	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Biseda telefonike	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikim online (e-mail)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përmes aktiviteteve në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vizita në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P3:** Cilat prej problemeve hasni më shpesh gjatë komunikimit me prindin/ërit e \_\_\_\_\_?

Shumë shpesh	Shpesh	Zakonisht	Rrallë	Tepër rrallë	Asnjëherë
<b>5</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>

	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>0</b>
Nuk vijnë në mbledhje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Nuk i kuptojnë problemet e fëmijës së tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk janë të interesuar për arritjet e fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk bashkëpunojnë me shkollën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk përcjellin informacion të vlefshëm për pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit nuk na mbështesin kur fëmijët e tyre shfaqin probleme në sjellje	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P4:** Si e vlerësoni komunikimin me prindin/ërit e \_\_\_\_\_ për sa i përket ndikimit mbi arritjet shkollore dhe sjelljen e tij?

Shumë të dobishëm

Të dobishëm

Disi të dobishëm

Aspak të dobishëm

*“Pyetësi i dytë i mësuesve, të dhënat e nxënësve”*

## PYETËSOR

### Të dashur prindër!

Pyetësoni ka për qëllim që të marrë mendimin tuaj lidhur me komunikimin (marrëdhënien) mësues-prind, si dhe ndikimin e këtij komunikimi në arritjet e fëmijës tuaj në shkollë. Të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për hartimin e një studimi, i cili ka qëllim që të përmirësojë marrëdhënien shkollë-familje.

*Ju lutem ta plotësoni pyetësonin me sinqeritet, pra të jepni përgjigje të sakta.*

### Faleminderit për bashkëpunimin.

### 1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM (Shëno me X alternativat që zgjedh)

<b>P1: Klasa që ndjek fëmija</b>	Klasa e _____
<b>P2: Gjinia e fëmijës</b>	<input type="checkbox"/> Djalë <input type="checkbox"/> Vajzë
<b>P3: Prindëri që merret më shumë me çështjet e shkollimit të fëmijës</b>	<input type="checkbox"/> Nëna <input type="checkbox"/> Babai
<b>P4: Numri i fëmijëve që ka familja</b>	_____
<b>P5: Personi që plotëson pyetësonin</b>	<input type="checkbox"/> Nëna <input type="checkbox"/> Babai <input type="checkbox"/> Së bashku
<b>P6: Vendbanimi juaj</b>	<input type="checkbox"/> Fshat <input type="checkbox"/> Qytet
<b>P7: Arsimi i babait</b>	<input type="checkbox"/> Fillor <input type="checkbox"/> I mesëm <input type="checkbox"/> Iartë
<b>P8: Arsimi i nënës</b>	<input type="checkbox"/> Fillor <input type="checkbox"/> I mesëm <input type="checkbox"/> Iartë
<b>P9: Punësimi i babait</b>	<input type="checkbox"/> I punësuar <input type="checkbox"/> I papunë
<b>P10: Punësimi i nënës</b>	<input type="checkbox"/> E punësuar <input type="checkbox"/> E papunë

### 2. BASHKËPUNIMI ME SHKOLLËN (Shëno me X alternativën që zgjedh)

**P2.1: Sa i përfshirë ndjeheni në komunikimin tuaj si prind me mësuesin e fëmijës/ve tuaj?**

Shumë i përfshirë;  I përfshirë;  I përfshirë me raste;  Aspak i përfshirë

**P2.2: Me cilat prej pohimeve më poshtë jeni dakord?**

Shumë dakord	Dakord	Disi dakord	Aspak dakord	Nuk e di
4	3	2	1	0

Pohimet	4	3	2	1	0
Prindërit duhet të kontaktojnë vazhdimisht me mësuesin e fëmijës së tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit duhet të kenë marrëdhënie të mira me mësuesin	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Është detyrë e prindërve që të kontaktojnë shkollën për t'u informuar mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Prindërit duhet të jenë prezent në të gjitha mbledhjet që organizon mësuesi në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mësuesi ka për detyrë të kontaktojë prindërit për çdo problem që paraqet nxënësi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mësuesi duhet t'i zgjedhë vetë problemet me nxënësit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Fëmijët duhet t'i zgjedhin vetë problemet që kanë me mësuesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Nuk është detyra e mësuesit të merret me problemet e nxënësit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P2.3: Si e vlerësoni shkollën për këto aspekte?**

Aspektet	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët	Shumë dobët
Mikpritja dhe kontakti	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Menaxhimi i shkollës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikimi me mësuesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Drejtimi i shkollës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**3. FORMAT E KOMUNIKIMIT MËSUES-PRIND (Shëno me X alternativat që zgjedh)**

**P3.1: Sa shpesh komunikoni me mësuesin?**

<b>Komunikimi me mësuesit</b>	<b>1 herë në muaj</b>	<b>1 herë në dy muaj</b>	<b>Çdo herë</b>	<b>Asnjëherë</b>
Komunikoj me mësuesin përmes mbledhjeve që organizon në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikoj me mësuesin përmes telefonit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikoj me mësuesin përmes e-mailit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Takohem me mësuesin në shkollë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Komunikoj me mësuesin përmes aktiviteteve që organizon shkolla	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mësuesi bën vizita në shtëpi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eskursioneve me prindër dhe nxënës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

**P3.2: Cilat janë format që dëshironi të komunikoni më shumë me mësuesin/shkollën? Deri në tri përgjigje!**

Mbledhjeve me prindër	<input type="checkbox"/>
Përmes telefonit	<input type="checkbox"/>
Komunikimit me e-mail	<input type="checkbox"/>
Nëpërmjet nxënësit	<input type="checkbox"/>
Takimeve brenda dhe jashtë shkollës	<input type="checkbox"/>
Pyetësorëve rreth opinionit tuaj për probleme të ndryshme	<input type="checkbox"/>
Vizitave në shtëpi	<input type="checkbox"/>
Përmes aktiviteteve që organizon shkolla	<input type="checkbox"/>
Eskursioneve me prindër dhe nxënës	<input type="checkbox"/>

**P4: Në përgjithësi, si e vlerësoni komunikimin që keni pasur deri më tani me mësuesit për sa i përket përfitimit që ka sjellë për fëmijën tuaj në nota, sjellje, etj?**

Shumë të dobishëm

Të dobishëm

Disi të dobishëm

Aspak të dobishëm

*“Pyetësori i prindërve”*